
INTERVISTË ME SHYQRI NIMANIN

Prishtinë | Data: 30 nëntor, 2016

Kohëzgjatja: 70 minuta

Të pranishëm:

- Shyqri Nimani (I intervistuari)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Noar Sahiri (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

[Intervistuesja e pyet folësin rreth kujtimeve të tij më të hershme. Kjo pjesë është prerë nga video intervista.]

Shyqri Nimani: Kam dëshirë t'ju rrëfej mbi historinë e jetës sime dhe momentet që ishin vendimtare për t'u marrë me artin figurativ. Unë kam lindur, ka dashtur fati, në Shkodër, meqë familja ime, nana dhe babai im u shpërngulën para Luftës së Dytë Botërore, u shpërngulën për në Shqipëri dhe u vendosën në Shkodër. Atje unë linda.

Pas dy vjetësh kaluam në Kukës, ku lindi edhe vëllau im Genci, dhe pas dy vjetësh të tjera ne kaluam në Prizren dhe nga Prizreni u vendosëm përsëri në Gjakovë prej nga vinte nëna, nëna dhe babi im, dhe pastaj unë vazhdova shkollën fillore në Prizren. Ndërsa Shkollën e Mesme të Arteve në qytetin e bukur të Pejës dhe pas pesë viteve studime atje, vazhdova me studimet universitare në Universitetin e Arteve të Beogradit, dhe atje zgjati gjithashtu studimi im për pesë vjet dhe në të njejtën Akademi. Pastaj përfundova edhe shkollën e tretë, pra studimet pasdiplomike, dhe në ndërkohë u shpall një, një konkurs mbarëjugosllav me ç'rast qeveria Japoneze jepte një bursë për përsosje artistike dy vjeçare në Japoni dhe unë e fitova atje dhe kalova për dy vjet në Japoni.

Pastaj u ktheva në Prishtinë kur filloi të punonte, ç'është e vërteta veç kishte disa vjet, Shkolla e Lartë Pedagogjike, dega e artit figurativ. Meqë Gjelosh Gjokaj, një artist i yni nga Mali i Zi, ai e braktisi Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe vajti në Itali, në Romë, për t'i vazhuar hulumtimet e veta artistike, ku për një kohë të gjatë ka jetu dhe vepru dhe në ndërkohë ka kalu deri në fund të jetës në Minhen të Gjermanisë. Unë pastaj...

Erëmirë Krasniqi: A po na tregoni, çka mbani në mend prej asaj kohe?

Shyqri Nimani: Po...

Erëmirë Krasniqi: Meqenëse paskeni lëvizë prej një vendi në vendin tjetër, pra çka ka qenë arsye, pse?

Shyqri Nimani: Po unë ç'është e vërteta isha që në moshën shtatë vjeçare, meqë babi im kishte vdekur dhe më kishte lënë tre vjeçar, nëna ime ishte shumë e re, ishte rimartuar dhe kishte kaluar në Shqipëri. Kështu që, unë u vendosa në Shtëpinë e Fëmijëve në Prizren dhe atje ishte, ishte një ambient shumë interesant meqë ne ishim mbi njëqind deri njëqind e pesëdhjetë nxënës të cilët e kishim përjetuar domethanë gjithë ato shkatërrime dhe kishim humbur dashurinë prindore. Dhe na kishin vendosur, pra shoqëria kosovare na kishte vendosur në këtë shtëpi e cila ishte shumë e mirë, kishte pedagogë të mirë dhe aty neve na ipshin mundësi që t'i shfaqim talentet tona, dhuntitë tona artistike.

Dikush mirrej me ndonji instrument, dikush shkruante poezi, dikush këndonte, kurse grupi i, disa shokë me mua, ne mirreshim me artin figurativ. Pra, na kishin dhanë ngjyra, na kishin dhanë letra, pastele të ndryshme dhe kështu. Më pas kthimit veror nga bregdeti Dalmatin i Kroacisë, unë kisha bërë, në vitin e dytë të Shkollës së Artit, kisha bërë një peisazh, mund të them të bukur meqë mësuesja ime e pëlqeu shumë. E mori ua tregoi kolegëve të mi, mua më morri për dore dhe më çoi në klasët e tjera për t'iu treguar nxënësve të tjerë, të klasëve të tjera. Edhe, “Ja ky shoku juaj, se sa bukur ka vizatuar, ka pikturuar në të vërtetë një peisazh...” ku ishte një anije në bregdet me vela t'bardha me disa palme këtu në plan të parë. Dhe ajo ishte shtytja, mendoj, shtytja ime e parë dhe mendoj që mësuesja ime, e cila ishte motra e Bekim Fehmiut, motra ma e vjetër, ishte një mësuese shumë e mirë dhe ajo, unë mendoj, kishte zbuluar për herë të parë që unë kisha talent për artin figurativ.

Pastaj, pastaj ishte me randësi që unë vajta në Shkollën e Mesme të Arteve. Atje kishim profesorë të cilët ishin, për atë kohë ishte shumë me rëndësi, që e kishin krye Fakultetin e Arteve. Ishin të gjithë të kualifikuar. Pra, ishte një staf shumë i mirë dhe aty na filluam të njifemi me artet figurative edhe pse asnjëherë profesori i historisë së artit nuk na filste për artin figurativ shqiptar por vetëm fliste për artin figurativ jugosllav, mirëpo...

Erëmirë Krasniqi: Çfare ishte në atë kohë, meqenëse ishte ende herët, po mendoj me kuptu çka është Jugosllavia? Ishin vitet... 16, 17 sa i bjen që ishin nën Jugosllavi?

Shyqri Nimani: Po unë mendoj që në atë kohë, në moshën time do të thotë diku 15—16—17 vjeçare, unë nuk mund të kuptoja. Si çdo fëmijë në atë moshë, nuk kupton ç'është politika, ç'është shteti, ç'është okupimi i cili është i kamufluar apo jo? Se aty flitej që kemi barazi të gjithë. Vllaznim Bashkim1 ka qenë parolla e cila ishte demagogjike natyrisht. Por, ajo që është deshtë dhe që është e zakonshme unë është deshtë të mirrem. Pra moshë, kjo moshë është me rëndësi të mirret të mësosh atë çfarë duhet mësuar dhe unë isha në gjendje ta shprehja pra talentin tim.... Dhe i kam disa shoqe të cilat ma vonë më kanë treguar që kanë qenë me mu në klasë. Thonë, “Sa herë që kërkonim diçka nga ti, ti vetëm vizatoje kurgjo tjetër”. Domethënë unë kam qenë i preokupim edhe në orët, domethënë edhe në orët e mësimit edhe ku kanë qenë lëndët tjera unë vetëm kam pasë dëshirë të vizatoj dhe kjo ka qenë diçka që ka treguar vërtetë preokupimin tim jetësor që sot të jetë arti pamor.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë stili, apo çfarë lëvizje në art u promovojshin prej Jugosllavisë në atë kohë, po mendoj çka ka qenë brumi që ju e merrshit në Shkollën e Mesme në Pejë?

Shyqri Nimani: Po, në Jugosllavi ç’është e vërteta në krahasim me këto shtetet tjera të kampit lindor të cilat ishin nën ndikimin e Bashkimit Sovjetik, që sot quhet Federata Ruse, atëherë soc—realizmi që ka ndodhë në të gjitha këto shtete dhe sidomos në shtetin tonë amë, në Shqipëri, në Jugosllavi u braktisën në vitet... në, në mesi i viteve të ‘50—ta. Për arsye se një piktor nga Kroacia shumë i njohur, Edo Murtić², ai ishte kthyer nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili kishte qenë me bursën e Fullbright dhe kishte qenë me një studio me Jackson Pollock. Tash merre me mend me Jackson Pollock... Dhe m’kujtohet edhe Edo Murtić më pat’ treguar, vetë ky piktor tashmë i ndjerë, se ai po ta kishte vetëm një pikturë t’vogël, sado të vogël të Jackson Pollock sot do të ishte bërë milioner. Pra kur me, me kthimin e këtij Edo Murtićit, i cili ishte një piktor par excellence, një piktor ekspresiv i shkëlqyer edhe unë ia kam pasë hapë një ekspozitë kur isha drejtor i Galerisë së Arteve të Kosovës, e pata hapë ekspozitën personale këtu te ne në Prishtinë. Edo Murtić ka qenë edhe mik shumë i mirë i shqiptarëve se patëm bërë një, një kontakt me galeritë e Jugosllavisë sidomos me atë të Zagrebit, e cila ka qenë Galeria Forum të cilën e udhëhiqte Vlado Bužančić i cili ka qenë historiani më i miri i artit dhe kritik i ish—Jugosllavi.

Kështu që kur u kthi ai në Jugosllavi, atëhere në Jugosllavi u braktis arti socialist dhe filloi arti i lirë dhe prandaj ne artistët e Kosovës kemi pasë një fat shumë të madh që nuk kemi qenë të kufizuar. Na nuk e kemi pasë të imponuar doktrinën e soc—realizmit në krahasim me vëllezërit tanë, kolegët tanë, shqiptarët në Shqipëri, të cilët me të vërtetë kanë vujtë për një kohë shumë të gjatë. Edhe pse një numër i tyre kanë kriju edhe vepra të cilat kanë... domethanë cilësi të jashtëzakonshme, janë të mira... për shembull Sali Shijaku është një piktor i cili që në atë kohë ka qenë shumë ekspresionist. Dhe kur e patëm vizitu ne Shqipërinë për herë të parë atje, ‘72—shën, ne e lavdonim një pikturë të tij se sa ishte e bukur, ekspresioniste edhe ai thoshte, “Oh ju lutem mos më lavdoni se do t’iu shoh sherrin”. Se në atë kohë normal do t’ia syrgjynosnin dikah në ndonji hapësirë të Shqipërisë se ku ka... ku nuk kanë mund të, të jenë të lirë apo jo, deri aty ka qenë çështja.

Kështu që për fat të mirë arti figurativ domethanë edhe në Kosovë në atë kohë ka qenë i lirë, i liruar dhe të gjithë artistët, duke filluar nga këto gjenratat e para ku ka qenë Agush Beqiri, Nuredin Loxha, Engjëll Berisha, Nysret Salihamixhiqi, Muslim Mulliqi e disa të tjerë kanë qenë krejtësisht të lirë. Kanë pikturuar secili në mënyrën e vet, secili ka... këta emra që i përmenda janë me të vërtetë shumë karakteristik, dikush është me një art ekspresiv, dikush me pak a shumë surrealist, dikush tjetër është ma me traditën tanë bizantine të transliteruar në art bashkëkohor.

Dhe ky është një fat shumë i mirë që na në Kosovë megjithatë deri kur erdh gjenerata ime kemi kriju një traditë në krahasim me ne që më parë nuk kemi pasë. Sot gjeneratat e reja mund të mburren se kanë, e kanë megjithatë, një traditë dhe i kanë ata piktorë më të cilët mund të thirren se, edhe të mburren më njëfarë mënyre, për arsye se të gjithë kanë marrë pjesë. Këta artista që i përmenda kanë marrë pjesë nëpër ekspozita bienale, triennale, qoftë në hapësirat e ish—Jugosllavisë por edhe në hapësirat Europiane edhe, edhe të kontinenteve të tjera.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi me juve mandej, ju e përfundutë Shkollën e Mesme dhe shkutë në Beograd?

Shyqri Nimani: Po.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me na tregu ma shumë për kohën e juaj gjatë studimeve...

Shyqri Nimani: Po.

Erëmirë Krasniqi: Apo rreth përpunimit tuaj artistik?

Shyqri Nimani: Mandej unë pas pesë vjetësh kryva Shkollën e Arteve Aplikative të Pejës e cila edhe një here e ceku ka qenë shumë e mirë, stafin e ka pasë shumë t'mirë dhe e kreu unë me një sukses të shkëlqyshëm. Dhe unë mendoja që sa i përket artit figurativ unë kisha mësuar. Mirëpo kjo ishte, kjo ishte një... praktikisht, një grackë e një të riu i cili megjithatë nuk e kishte parë ende botën a po jo? Sepse Kosova ishte bukur e prapambetur. Qytetet tona ende, na nuk kishim ende universitet që është një gjë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe nuk kishim ekspozita. Nuk kishim galeri dhe me mësimin që kisha bërë unë në Shkollën e Artit dhe i kisha marrë notat e shkëlqyera unë mendoja se tash krejt bota është e ime dhe kur vazhdova në Beograd unë doja të...

Erëmirë Krasniqi: A kishit mujtë ma shumë me na tregu për, për këtë farë mungesën e artit në publik se shumë po duket interesant. Si... që s'ka pasë ekspozita që në fakt ju, ju nuk keni pasë qasje në art, nuk kanë qenë... përditshmëria nuk ka qenë shumë e estetizime, kështu që a kishit mujtë me na tregu qysh, qysh ke vendosë me bo diçka që ka të bëjë me art e në të njëjtën kohë nuk keni pasë publik?

Shyqri Nimani: Shumë, shumë bukur, shumë, shumë qenësore kjo pyetje. Është e vërtetë që e tillë ishte Kosova, ishte shumë e prapambetur, domethanë tek mas Luftës së Dytë Botërore erdh komunizmi. Se përpara Jugosllavia ka qenë mbretëri dhe shqiptarët nuk i kanë pasë kurrfarë të drejtash. Dhe me komunizëm me njëfarë mënyre me parollën e tyre që komunizmi po e ndërton një shoqni e cila e kishte sintagmën, Vllaznim Bashkim që thashë ishte një demagogji.

Por ndoshta për sllavët që ishin në hapësirën e ish—Jugosllavisë mund të kishte ndonjë, ndonjë rëndësi, por për ne shqiptarët ne nuk kishim diçka ma mirë sesa që kishim filluar të fitonim disa të drejta fillestare, t'i kishim shkollat fillore, shkollat e mesme. Edhe pse në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë na vetëm gjuhën shqipe si lëndë e kemi pasë në shqip, të gjitha lëndët tjera kanë qenë në serbo—kroatisht, dhe kjo tregon se sa kemi qenë na, domethanë të, të padrejtat tona domethanë kombëtare dhe elementare. Dhe kështu që krejt është mvarë prej talentit të cilin e kemi shprehë na vet.

Për shembull, mu më kujtohet, vajta une prej Pejës në Gjakovë dhe atje u takova me Muslim Mulliqin. Edhe Muslimi ishte, kishte filluar ma i vjetër, ishte nja shtatë vjet ma i vjetër se unë, por Muslimi po përgadiste një ekspozitë të artit figurativ me piktura të tij dhe më ftoi domethanë në shtëpinë e tij t'i komentojmë ato, domethanë kjo ishte krejt çka kishim na. Ndoshta ekspozita e parë e Muslimit edhe ndonji piktori tjetër, në hapësira, edhe as vet nuk e di se çfarë hapësira kanë qenë se s'kemi pasë galeri apo jo? Ose nëpër disa hapësira të shkollave janë hapë.

Pra kjo, këto kanë qenë tentativat e para të jashtëzakonshme që jo vetëm ne, gjeneratat e reja të cilët ishim të talentuar në artet figurative, në letërsi se pat' filluar në atë kohë edhe letërsia. Sidomos poezia ishte, u zhvillua me të madhe, ishte poeti Ali Podrimja, unë e kisha shok atë dhe takoheshim edhe ishin gjeneratat ma t'vjetra si Esad Mekuli. I cili ishte poet dhe ishte përkthyes, dhe më vonë ai udhëhiqte revistën e parë në gjuhën shqipe "Jeta e Re", e cila ishte praktikisht, ishte një kopsht ku jo vetëm poetët, shkrimtarët, por Esad Mekuli ishte një njeri aq largpamës sa që në çdo numër të "Jetës së Re", e cila dilte një herë në muaj i botonte edhe, edhe një, një numër të vizatimeve apo të pikturave të një artisti të ri që po vinte në Kosovë.

Kështu pra me një vullnet mund të them spontan, jo të imponuar, dhe në rrethana jo të përshtatshme gjithmonë gjindet domethanë gjindet hapësira, krijohet vullneti, devotshmëria është numër një. Prandaj në këtë mënyrë ne nuk kishim me të vërtetë ku të shifnim, nuk kishim libra të historisë të artit që është gjë, gjë shumë e rëndësishme. Ato ekzistonin vetëm në gjuhët sllave apo ndonji gjuhë tjetër, për shembull. Mirëpo, ne duhet të mësonim se në Shkollën e Artit mësonim pos shqipes, serbishten, frengjishten edhe gjermanishten e unë kisha filluar vet ta mësoja edhe anglishten që në Shkollën e Artit. Sepse më pëlqenin këngët e këngëtarëve të njohur atëherë dhe kisha dëshirë që ato këngë t'i kuptoj se për çka flasin ato.

Edhe atëherë unë fillova vet ta mësoj anglishten dhe kjo na ka ndihmu që ndoshta kur ke... që të shfrytëzohet rastin sidomos kur kemi shkuar të studiojmë në Beograd. Kanë ekzistuar edhe bibliotekat, ka qenë Qendra Informativ Kulturore Amerikane, e cila ka pasë bibliotekë të jashtëzakonshme, ka pasë libra të historisë së artit sikur që edhe ka pasë, kanë pasë edhe bibliotekat e Beogradit dhe natyrisht në Beograd mandej na u hapën horizontet. Meqë atje kishe shumë galeri për një mramje mund të hapeshin 20 deri 25 ekspozita ashtu që ishte vështirë për ne të caktonim se në cilën do të shkojmë, por kishim rastin që t'i vizitonim ma vonë.

Pra ka qenë shumë e vështirë, mirëpo në hapësirat pra kosovare për ne gjeneratat e para të Kosovës që jemi marrë me art figurativ meqë arti figurativ te na është ba spontanisht dhe kjo ka tregu domethanë që nuk na ka inspiru diçka tjetër por vetvetiu domethanë ajo që është në shpirtin e njeriut. Domethanë ka shpërthyer dhe na atëherë kemi pasë mundësi ambientet kanë qenë shumë të bukura, ambienti i Pejës për shembull, Gryka e Rugovës, ato kullat e bukura shqiptare edhe të gjitha ato. Kanioni i Rugovës e të gjitha ato na kanë shtyrë që të vizatojmë, të pikturojmë dhe natyrisht një numër nga ato punime i ruajnë dikush prej nesh.

Unë i kam rujtë disa edhe kolegët tjerë i kanë rujtë se megjithatë punimet e para kanë randësi shumë të madhe se kur kalojnë vitet ju do të jepnit shumë dhe çdo gjë që ta kishit një punim nëse nuk e keni, se çfarë keni bërë atëherë. Dhe unë e kom pasë punu në Shkollën e Artit diku në vitin e pestë një intarzion, intarzion është një teknikë me furnir punohet, një, një peisazh, një anije përsëri po lidhet anije se mu gjithmonë m'ka pëlqy deti. Ka qenë një anije në furtunë, në shtrëngatë edhe atë drejtori i shkollës ia kishe dhanë një ushtaraku. Edhe unë sot, për dhuratë që e kishte vizitu Shkollën e Artit, edhe unë sot, sot kisha dhënë kushedi çka sikur vetëm ta shihja se si e kam punu atë, kur drejtori i shkollës e ka vlerësu që duhet t'ia jepë dhuratë dikuj domethanë një musafiri të lartë ushtarak.

Prandej po them që arti është diçka që del nga shpirti i njeriut, me art nuk mund të mirret çdokush, arti figurativ mandej teatri, letërsia ato janë gjëra të cilat u përkasin vetëm atyre që kanë dhunti nga Zoti, apo kanë dhunti nga pedigreeja familjare. Nëse dikush në familje është marrë me art atëherë natyrisht se do të ndikojë edhe, edhe te fëmiju. Por unë nuk e kam pasë as nanën as babën prandej as vet nuk e di se si ka dalë nga unë domethanë talenti për artin figurativ poashtu sikur që del edhe për të gjithë njerëzit e tjerë. Edhe e pashë xhaxhain tim, i cili jetonte atje, ishte drejtor i një institucionit, edhe më takoi tha, “Ku je t’u shku?” Thashë, “Po shkoj të regjistrohem...” Më takoi rastësisht me një bulevard të Beogradit bash në ato momente kur unë po shkoja me u regjistru në Akademinë e Muzikës. Edhe ai më tha, “Jo”, tha “po ti e ke kry Shkollën e Artit, ti duhesh të vazhdosh në Akademinë e Arteve”. Edhe ai qëllloi ashtu se kushedi çfarë jete do të kisha po të kisha shku në Akademinë e Muzikës.

Edhe unë u regjistrova. Ishte shumë vështirë sepse provimi pranues zgjatë shumë, zgjatë pesë ditë edhe ishte konkurenca e madhe, ishim në atë kohë rreth 18—20 milion qytetarë të atij shteti. Edhe ishte shumë e vështirë, vinin nga 300—400 konkurent nga mbarë Jugosllavia e na kosovarët e kishim shumë vështirë për me qëndru pesë ditë gjatë provimit pranues na duhej te shkonim në shtëpinë e studentëve atje te ndonji shqiptar, student i yni ma i vjetër, dhe flenim për shembull me një shtrat nga dy vetë, nga pesë ditë për me arritë. Udhëtonim nga, nga Prishtina për në Beograd me tren, treni udhëtonte shumë ngadale, ishim të lodhur. Duhej me pritë ditën kur shpallej, kur shpallej domethanë rezultati dhe kur e shihnim na se në mesin e 300 e sa kandidatëve na ishin pranuar tridhjetë e sa në dymbëdhjetë seksione. Në fakultetin ku isha unë të Universitetit të Beogradit dhe në degën e Dizajnit Grafik ku u pranova unë ishin vetëm gjashtë vetë kështu që ishte një, një kënaqësi e madhe.

Mirëpo Beogradi ishte një metropol, i cili është një qytet me traditë të madhe historike të cilën e kanë sundu gjatë historisë për 2000 vjet shumë, shumë perandori të ndryshme dhe jep mundësi të mëdha. Ka një shtrirje gjeografike të jashtëzakonshme, i ka dy lumenjë, dy lumenjë të mëdhenjë Savën dhe Danubin, e ka kështjellën e Kalemegdanit, ka shumë muze, ka teatre, ka biblioteka. Kishte Akademinë e Shkencave dhe Arteve, kishte përfaqësinë diplomatike të shumë shteteve të cilat kishin qendra kulturore ku ne mund të shkonim dhe të lexonim edhe në italisht, edhe frengjisht edhe anglisht edhe gjermanisht.

Kishte pra po them muze, ku mund t’i shikonim të gjitha ato piktura, jo vetëm artin Jugosllav por kishte edhe art ndërkombëtar, muzeu i Beogradit kishte, i kishte veprat e Picassos, Modiglianit ekspozoheshin edhe ekspozita, na e kishim parë një herë edhe ekspozitën e Van Goghut, ekspozitë shumë e madhe se një kohë ishte bërë Beogradi një, një qytet metropolitan edhe ndodhnin ngjarje të mëdha jo vetëm nga fusha e arteve figurative por kishte panairë të ndryshme gjatë, dymbëdhjetë panairë të, për shembull të librit, mu m’pëlqente panairi i librit ndërkombëtar kur mund të bleja libra në gjuhë të huaja edhe të historisë së artit. Pra horizontet tona mund të hapeshin me të madhe, ishte pra... ishte pra një botë krejt tjetër, ishte një kontrast i madh me qytetin tonë të vogël të Pejës, por shumë të bukur apo jo? Mirëpo edhe ai qytet i kishte edhe bukuritë natyrore.

U futëm në Akedeminë e Arteve, Akademia ishte shumë e fortë, me profesora të cilët kishin studiuar në botën e jashtme domethanë në Pragë, në Minhen, në Paris dhe të cilët gjithë atë bagazh të madh që kishin vjelë në ato qytete dhe që kishin mësuar e kishin sjellë në vendet e tyre, sidomos në Beograd, Zagreb, Lublanë. Dhe shihej ndikimi edhe një numër i madh i piktorëve tanë të Kosovës që kanë studiu, këta duhet ta cekë, që kanë studiu në Beograd, Zagreb, Lublanë kanë marrë ndikimin e atyne profesorëve të cilët kanë pasë ndikimin nga, nga studimet e tyre në, që i thashë këto qytetet europiane. Dhe në fillim të këtyre artistëve tanë të Kosovës pra kur janë kthyer shihen, shihen pra ndikimet e profesorëve të tyre. Dhe kjo është gjë e natyrshme për arsye se mendohet që nga shekulli XIII edhe Giotto ka pasë një ndikim të vetin.

Mandej edhe Leonardo e ka pasë dikënd edhe Michelangelo edhe Picasso e ka pasë, por në ndërkohë ato flaken edhe atëherë e krijon doktrinën e tij. Ai që mbetet nën ndikim të tjetërkuaj ai do t'jetë i humbur apo jo? Mirëpo një numër i madh i këtyre piktorëve të Kosovës, nuk mund të them i madh, relativisht i madh meqë mund të ngjehen me gishta. Megjithatë, e kanë krijuar domethanë doktrina edhe shumë origjinal vijnë, dhe e kanë zënë vendin e tyre në panteonin, mund të themi panteonin, sado i madh apo i vogël të artit mbarëkombëtar shqiptar.

Erëmirë Krasniqi: Çka ishin ndikimet e juaja në artin e juaj që e zhvillojshit, a mundeni me na kallxu pak për punën e juaj gjatë studimeve në dizajnin grafik?

Shyqri Nimani: Po, do të thotë që në fakultetin tonë të arteve, për pesë vjet, dy vjetët e para kanë qenë të përbashkëta, domethonë më mësonin vizatimin, pikturën, skulpturën dhe disiplinat, aktin, nude që i thojmë apo jo... e tjera, e tjera, ato kanë qenë të përbashkëta. Mbas vitit të dytë, atëhere na orientoheshim. Kanë qenë dymbëdhjetë seksione, do të them dymbëdhjetë domethonë departamente apo katedra dhe unë u vendosa të shkoj në, në katedrën e dizajnit grafik, meqë, meqë nuk kishim në Kosovë asnjë që ishte në këtë fushë. Po nuk ishte kjo që kisha menduar për këtë çështje por ma vonë e kuptova që nuk kishte asnjë nga kjo fushë në Kosovë, ndonji artist i shkollum në fushën e dizajnit grafik dhe unë, më pëlqente, më pëlqente për arsye se dizajni ka diçka më tepër se sa ka për shembull piktura ose vizatimi apo skulptura.

Për të qenë dizajner duhet me qenë vizatues i shkëlqyeshëm, piktor i shkëlqyeshëm, duhet ta ndjesh ngjyrën, të jesh, ta ndjesh volumenin domethonë dimenzionin e tretë me njëfarë mënyre të jesh. Të kesh ndjenja edhe për skulpturë, por mbi të gjitha dizajni e ka porosinë artistike, e ka metaforën dhe ai duhet patjetër të komunikojë. Për arsye se kur e krijojmë një pikturë, një grafikë, një vizatim, një skulpturë ajo mund të shitet te një person privat apo mund të shitet për një galeri. Dhe me kaq, nuk ka tjetër ajo është unikalë kurse në fushën e dizajnit ekziston tirazhi, po edhe grafika e ka tirazhin e vet mirëpo ajo e ka të kufizumë, dhjetë de në njëzetë, tridhjetë. Seriografia, për shembull screen që i thojnë amerikanët ajo mund ta ketë edhe njëqind—dyqind kopje për arsye se ajo po, po shndërrohet pak në industri grafike. Kurse akuatinta grafika domethanë e shtypit të thellë, bakërshkrimi, mezo-tinta, ato e kanë tirazhin e kufizumë dhe meqë e ka tirazhin e kufizumë, masi që të shtypen 20 apo 15 kopje. Atëherë me një komision ato grrithen anulohen që ma autori nuk guxon të shtypë se përndryshe ato ta hupin vlerën, apo jo.

Kurse në dizajn, për shembull poster i thojnë frëngjisht affiche apo në gjermanisht plakati e ka tirazhin shumë t'madh ai komunikon me miliona njerëz, ata njerëz mujnë me qenë intelektual, mujnë me qenë pseudo—intelektual, mujnë me qenë analfabetë njerëz. Por kur ta sheh pjesën vizuale ai duhet të kuptojë se për çka është fjala, nëse e kemi një poster teatral apo filmik apo sidomos këta politik janë shumë, shumë të randësishëm që duhet t'ia jep një porosi politike. Apo e kemi posterin kundër luftës dhe atëherë duhet, duhet të jenë domethonë qato metaforat figurative shumë të fuqishme që të lexohen. Prandaj mua më ka pëlqyer shumë posterit pastaj më ka pëlqyer shumë, më kanë pëlqyer shumë llogot apo emblemat sepse ma vonë unë i kam studiuar dhe kam shkruar edhe libra për heralldikën shqiptare se na i kemi, stemat tona janë ma të vjetrat në Europë. Sidomos stema e Kastriotëve e cila është, mburojën e ka, në heralldikë njifet që, si Normane, është e shekullit XI.

Prandaj të gjitha ato më kanë futë dhe, edhe, edhe më kanë angazhu. Për atë arsye se aty çdo gjë duhet me qenë e saktë, duhet me qenë, nuk mundën me bë një poster i cili është abstrakt, për shembull se nuk ka vlerë nuk ka funksion. Kurse në pikturë e grafikë kënaqemi, futemi në studio e kemi pëlthurën pikturojmë çka t'na do shpirti nuk jemi të varur prej askujt, kurse në poster, në llogo ekzistojnë edhe komisionet. Merreni me mend që ju keni me punu, domethonë projektin e juaj duhet ta mbron para një komisioni, domethonë në atë komision. Duhet me qenë pesë vetë, mundën me qenë shtatë vetë, mundën me qenë njëmbëdhjetë vetë dhe ata mundën me qenë dikush i shkollim, dikush krejtësisht analfabet në fushën e estetikës dhe ju tash keni ballafaqime shumë shumë të ashpra.

Prandaj m'ka pëlqy dhe jam futë në dizajn dhe pastaj kam punu katër vjet për Teatrin Popullor të Beogradit, për Operën, për Baletin dhe Dramën. Dhe kam, kam punu shumë kom ilustru libra kom punu. Për shembull, [Sergei] Yesenin që është kompleti i librave, për herë të parë në Jugosllavi është botu, une pikturova me ballina me mrenda me kështu edhe fitova shpërblimin e panairit të Beogradit si kompleti ma i mirë kështu që jam shumë i kënaqun që jom futë në dizajn dhe kam pasë forcën që... dizajni gjithashtu kërkon dhe intelektencë, kërkon që të lexoni shumë, të dini shumë se çdo detyrë që e merrni, për shembull mu ma dhanë me e punu teatrin e Beogradit posterin për Trubadurin për “Il trovatore” të Giuseppe Verdit. Edhe atëherë unë është deshtë me e lexu ma së pari libretin me e ditë, a nëqoftëse nuk e kisha njoftë une muzikën e Giuseppe Verdit, mos t'kisha shku une në operën e Beogradit, aq shumë i kom ndëgju domethonë operat edhe mos ta kisha ditë që ngjarja po ndodhë në Spanjë, mos t'kisha pasë njohuri natyrisht që edhe posterin nuk do ta kisha bërë ashtu siç ndoshta... do të kisha dështu.

Mandej edhe kur ta lexojmë një poet mu m'ka ra mandej ma vonë t'i ilustroj të gjithë poetët e Kosovës, të gjithë i kom lexu, të gjithë i kom ilustru edhe poetët e tjerë botëror të cilët më kanë pëlqy. Kështu që domethanë në, në mendjen time unë është deshtë të pasurohem se sa ma shumë që lexojmë sa ma shumë që shikojmë aq ma tepër do të jemi në gjendje edhe ne që të shprehim në mënyrë sa ma cilësore.

Erëmirë Krasniqi: Sa keni qëndru në Beograd?

Shyqri Nimani: Në Beograd Akademia ka zgjatë pesë vjetë mandej menjihërë kam konkuru dhe jam pranuar i vetmi, për edhe dy vjet, për dy vjet në magjistraturë edhe ajo ka qenë një kohë shumë e mirë, jashtëzakonisht e mirë. Se magjistratura në krahasim me tash që e kanë studentat tanë me master me këtë formulën e Bolonjës këta sikur viti i parë, i dytë, i tretë që është në bachelor dhe, edhe, edhe masteri po zgjatet me aq landë. Kështu që, studentët nuk po e kanë ndonjë përkushtim ma t’lirë, na e kemi pasë vetëm një landë. Dy vjet unë jam marrë vetëm me temën time kjo ka qenë diçka jashtëza... se pesë vjet fakulteti, edhe madnej edhe këto dy vjet.

Edhe mandej unë edhe ma herët e thashë që vazhdova në Japoni për dy vjet ajo ka qenë një periudhë e jashtëzakonshme ku unë kisha marrë eksperiencë të madhe edhe në krijimtari edhe në njohuri nga historia e artit edhe atëherë në Japoni unë vetëm hulumtojshe. Më interesonte poezia haiku Japoneze e cila shkruhet në tri vargje në 17 rrokje fillon nga shekulli i XVI—XVII, pastaj kom shku i kom pa grafistët më të mirë japonez që kanë punu në stilin e grafikës ukiyoe. Domethonë zhanret, zhanret e jetës së përditshme japoneze ku është Hogusai, Hiroshige, Utamaru këta janë tre piktorë të jashtëzakonshëm i kanë punu gra... që kanë punu grafikën me ka dymbëdhjetë pllaka, domethonë të drurit të qershisë janë të jashtëzakonshme.

Mandej i kam shiku edhe madje gjithashtu edhe ekspozitat e mëdha të pikturës bashkëkohore japoneze, Nihonga që e quajnë ata domethonë Nihonga. Edhe në pikturë të stilit japonez se japonezët ende e asaj dite e vazhdojnë, ndoshta 80—90 përqind, prej tyre stilin japonez edhe një numër i vogël mirret me artin bashkëkohor. Mirëpo e kanë të zhvillim shumë edhe posterin, fotografinë artistike dhe unë i kam parë shumë miq atje i kam njoftë, për shembull dizajnerin ma t’mirë japonez i cili quhet Tadhana Orioko dhe fotografën Kishin Shinoyama. Këta janë dy artistë numër një në Japoni. Pra njëri është për dizajn për poster tjetri është për fotografinë artistike dhe kështu që në Japoni i kam zhvillu edhe ma shumë, i kam zgjeru edhe më shumë horizontet e mija në çdo pikëpamje.

Erëmirë Krasniqi: Gjuha vizuale a ishte shumë e ndryshme, a ishte lehtë ju me komunikuar me ato, ato principe të dizajnit?

Shyqri Nimani: Po, unë deshta, se harrova të them se unë së pari për ato dy vjet kam shku në Osaka për gjashtë muaj në kursin intenziv të gjuhës Japoneze. Kështu që, është deshtë që gati, gati nga tetë orë në ditë me e mësu japonishten dhe ka qenë shumë gjë e vështirë. Dhe une, Erëmirë [i drejtohet intervistuesës] me t’thanë t’drejtën në fillim me një shok timin e kisha prej Kroacisë dhe ishin edhe dy vajza nga Jugosllavia, Amelita dhe Tamara studiojshin arkitekturën. Unë si shkova atje fillova, thashë hajt po shkojmë me këtë Dalmatincin, Ivan e kishte emrin, hajde po shkojmë tash edhe po bëjmë disa aventura, po shkojmë në Kyoto, kryeqyteti i Japonisë po shkojmë në Nara mandej në ishullin Karazu, mu në jug të Japonisë.

Japonia i ka katër ishuj të mëdhenjë, e ka Hokkaido, Honshu, Kyushu edhe Shikoku krejt këto katër ishuj edhe 4000 ishuj të vegjël të pabanum edhe shkum na me ba aventura me shokë e me shoqe. Dhe kur u kthym mas një kohe ata na thanë, “Nëse ju nuk... kur të hyni në provim në fund do ta jepni provimin nga gjuha dhe letërsia Japoneze, nëse ju nuk do të jeni në gjendje me e dhonë provimin ose do të hyni edhe gjashtë muaj në kurs ose do të ju kthejmë në atdhe”. Kështu që ky Ivani nuk u kthy ma

se mbas pushimit shkoi e kishte t'vështirë edhe ushqimin e kishte të vështirë edhe nuk e njihte anglishten mirë se na mësojshim anglisht—japonisht.

Pjesa e Dytë

Shyqri Nimani: Meqë unë me të vërtetë e shfrytëzoja rastin që në Japoni të shoh sa më shumë, të mësoj sa më shumë edhe të krijoj sa më shumë, unë vendosa që në fund të qëndrimit tim në Japoni të hap një ekspozitë. Kur e kreu kursin gjashtë muaj, gjashtë muaj, e dhashë provimin e mora diplomën edhe kaluam prej Osakas në Tokyo dhe në Tokyo atje i kisha kushtet, ata kishin hotel për të huaj. Edhe aty kishim kushtet, mandej japonezët gjithnjë ishin në gjendje që nëse unë dëshiroja bëja një projekt për njëzetë ditë për dhjetë ditë të shetitja dikah nëpër Japoni, dhe qeveria japoneze do të thotë monbusho [Ministria e Kulturës], ata atëhere ma aprovonin m'i jepshin mjetet dhe unë fillojsha dilsha nëpër krejt Japoninë për me hulumtu edhe për t'ia arritë për t'i mësuar ato gjëra që më interesonin.

E Japonia ka aq shumë gjëra, aq shumë kulturë saqë me nejtë njo dy vjet edhe katërdhjetë vjet është vështirë të, të njihesh me gjithë atë kulturë aq të madhe. Dhe mandej e krijoja një cikël me punët të cilat ishin piktura të punume domethonë me dorë të gjithat, katërdhjetë punimet edhe i quajta “Japonia e bukur dhe unë”, ajo ishte domethonë sintagma apo sllogani. Edhe kur e kreu u takova me një artist të njohur japonez i cili e kishte, e kishte galerinë e tij shumë të mirë. Dhe ma dha ai domethonë pa të holla, për arsye se ishte shumë e shtrejtë mund t'i jepshe për shembull deri në 20.000 dollarë për me mujtë me majtë një muj ditë domethonë ekspozitën. Kurse ky njeriu Takashi Kono është një dizajner shumë i madh edhe ai ka dizajnu nëqoftëse ju kujtohet lojrat olimpike domethonë në Tokyo kur kanë qenë, krejt ato logot posteret ky njeri i ka punu. Edhe ishte shumë i mirë edhe aty unë e hapa ekspozitën, ishte ekspozita e suksesshme edhe i kom të gjitha ato. Atje e kanë... zakonisht e bojnë edhe këtë, e lojnë një fletore, një, një si me thonë një bllok të madh edhe njerëzit kur vijnë regjistrohesh, i shënojnë përshtypjet. Edhe ajo ishte, unë i kam rujtë i kam sjellë këtu edhe ekspozita me të vërtetë pati jehonë.

Meqë temat që i kisha marrë unë kishinin të bënin edhe me luftën kundër pollucionit, për arsye se Japonia ishte, po zhvillohej me t'madhe, kishte industri jashtëzakonisht të madhe. Edhe një ditë unë isha duke udhëtu me një mik timin një piktor japonez shumë i mirë Yoshi Dasan, ai vinte gjithmonë më thirrte mua me makinën e tij edhe shkonim nëpër ato restorantet japoneze ku ushqeheshim me ushqim deti. Edhe një ditë isha unë duke udhëtu me shinkansenin, shinkansen është treni ma i shpejtë në atë kohë ka qenë në Japoni 280 kilometra në orë ka ecë, edhe kur po shof prej trenit, po shof mali Fujiyama. Fuji është mali ma i lartë në Japoni, mali i shenjtë i thojnë, edhe i ka katër mijë metra lartësi.

Edhe e pashë që krejt prej fabrikave domethonë të mëdhaja prej tyntarëve ishte mbushë domethonë gati qielli me tym, edhe kështu unë e morra një ide edhe pikturova një pikturë në formë, domethonë në formatin e gjatë elegant {tregon e duar} sikur ato rrotullat japoneze scrolls. Të cilat japonezët kur kanë pikturu {shpjegon me duar} e kanë pasë pelhurën e kanë sillë edhe mandej e kanë hapë, kanë shkru poezi, kanë shkru përshkrime, kanë pikturu. Edhe unë në atë mënyrë deshta me bo atë edhe japonezët e kishin pëlqy atë se e kisha shkru, Quo Vadis Nihon? Ka po shkon Japoni? Kireina Nihon, domethonë, Pastrojani Japoninë, edhe japonezëve ju ka lanë përshtypje shumë të madhe.

Mandej e merrsha jetën e geishave se edhe ato ishin, janë shumë, tash në Japoni mendojnë njerëzit që femrat janë shumë të bukura, unë po them që në njëqind vajza një është e jashtëzakonshme, se zakonisht ato nuk janë edhe aq të bukura. Mirëpo, geishat kanë qenë femra në shekullin XVI, XVII të cilat kanë shërby nëpër ato shtëpitë publike. E sot në Japoni i quajnë toruko, se banjo turke e toruko e quajnë, edhe aty ekzistojnë këto geisha të cilat janë të veshura me kimono, i bijnë instrumenteve shamisen, është një instrument gati, gati si sharkija e jonë. Mandej recitojnë poezi të bukura japoneze, bëjnë masazhë e të tjera, tjera.

Kështu që të gjitha këto tema shumë interesante nga jeta japoneze unë i kam marrë dhe i kam pikturu në këto, në këto katërdhjetë punime dhe sidomos kam pikturu, i kam transliteru, ajo çka është verbale tekstet e këtyre poetëve si është Basho, Buson, Issa e të tjerët dhe i kam shndërru në piktura. Mirëpo asnjë punim s'e kam shitë atje për arsye se punimet origjinale shumë më dhimbën dhe asnjëherë nuk kom pasë dëshirë me i shitë. Edhe kom pasë dëshirë me i pru në Kosovë dhe këtu një ditë, domethanë ia lë familjes, mirëpo ajo duhet patjetër të shkojë në Galerinë Kombëtare të Kosovës, kur të kalon koha, edhe kom pasë shumë vështirësi me i pru deri këtu, apo jo? Me i bartë nëpër aeroplana, pa i regjistru disi edhe kështu. Është një histori në veti se si i kom sjellë ato këtu, edhe kështu që kur jam larguar nga Japonia mendoj që i kam arritë të gjitha ato që kam dashtë me i arritë. Pra kom mësu shumë, kom kriju shumë, dhe e kom si kurorë e gjithë kësaj ka qenë hapja e ekspozitës sime edhe i kom ato të regjistruara në shumë edhe në filma edhe në video edhe në fotografi. Meqë në Japoni fotografia është aq shumë e zhvillume, ato kompanitë e tyne, aparatet e tyne janë, dihet Nikon, Minolta e tjera, tjera.

Erëmirë Krasniqi: Ku u kthyet, a u kthyet në Beograd?

Shyqri Nimani: Jo.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kthyet prej atje?

Shyqri Nimani: Kur u ktheva, kur u ktheva, ç'është e vërteta unë kur kom magjistru në Beograd, profesori im më pat' thanë. Mirë që e përmende këta se është shumë gjë me rëndësi, është një eksperiencë e jashtëzakonshme. Profesori im më tha, "Nimani", se ata të thërrasin me mbiemër, tha, "mos shkoni atje" tha, "jo që po nënçmoj unë Kosovën", por tha, "provinca herët a vonë", tha "ka me ju shkelë". Do të thotë që Kosova është provincë. Po edhe sado që ki me shku ti me dhonë kontribut, mirëpo provincë është, vështirë është ajo edhe ka me ju shkelë. Unë i thashë, unë s'kisha mendu për këtë fare, thashë, "Unë do të kthehem në Kosovë për arsye se Kosova ma ka dhonë bursën mua për me studiu". Se "Rilindja" ma pat dhonë, shtypëshkronja "Rilindja" për pesë vjet, edhe për magistraturë mandej na pat' dhonë Këshilli Krahinor domethonë Qeveria e Kosovës në atë kohë. Kanë qenë bursat e jashtëzakonshme, gjeneratat e para na kemi qenë disa që u regjistruam në studimet pasdiplomike, edhe kanë qenë, për me kuptu se sa ka qenë kjo bursë diferencë e madhe, vitin e pestë të Akademisë une e kom pasë pesë mijë dinarë. Kurse vitin e parë kur kom fillu në tetor, të shkallës së tretë e kom pasë 110 mijë dinarë.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë vlere kishin këto dinarë?

Shyqri Nimani Është diçka e madhe po qe mujmë edhe një krahasim me bo pesë mijëshi me 110 mijë. Pesë mijë me 110 mijë. Sikur me thonë pesë mijë euro me 110 mijë euro njësoj është ajo apo jo? Se nuk e di tash se duhet me kqyrë se sa ka qenë, sa ka qenë kursi. Po për me kuptu mirë unë po tregoj që hoteli për shembull një hotel, unë shkova menjherë në hotel jo në dom të studentëve me ka pesë vetë (të gjithë qeshin). Unë vendosa të shkoj në Hotel General Turist në Beograd, hoteli i ri. Edhe i pyta ata, “Sa kushton për një muj?” Ata thanë, “Tridhjetë mijë dinarë”, tridhjetë mijë dinarë, çdo ditë ka një mijë dinarë, unë thashë, “Ok, po e marr”. “Po ku keni pare ju, çka jeni ju?” Tha. Unë thashë, “Jom student i shkallës së tretë”. “Po ku keni, këto janë tri rroga, katër rroga janë ato”. “Kom”. Thashë unë. Ia tregova vërtetimin që kisha marrë edhe atëherë ka qenë domethanë udhëheqës këtu, shumë interesant, kur e kom pa dokumentin tem, Ukshin Hoti, të ndjerin të cilin e kanë ekzekutu serbët. Pra Ukshin Hoti ka qenë ai i cili, ajo gjenerata jonë e re që ka ndihmu në zhvillimin e Kosovës shumë.

Erëmirë Krasniqi: E pjesë e çfarë plani kanë qenë këto bursa, të zhvillimit të Kosovës?

Shyqri Nimani: Po, në zhvillimin e Kosovës janë dhanë në disa fusha. Unë nuk e di sa kanë qenë, por unë e di që e kom marrë unë, është në degën e muzikës Zeqirja Ballata, ai shkoi në Akademi mandej ka shku në Lublanë edhe të tjerë. Tash nuk e di sa ka qenë numri, mirëpo kjo ka qenë diçka e jashtëzakonshme, me të vërtetë e jashtëzakonshme. Se tash për shembull ti tridhjetë mijë e ke pagu hotelin, për shembull sot te na një hotel shkon mesatare njëqind apo jo? Domethanë tre, tre mijë euro është dashtë me pagu mandej 30 mijë unë i dhashë për ushqim u bonë 60 mijë. Mandej shkova i bleva biletat për tramvaj e trena apo trolibus. Mandej bleva ngjyra nja 20 mijë dinarë edhe kisha disa tjera për libra apo diçka. Kështu që, kështu që unë nuk kom harru kom thonë, “Kosova m’i ka dhonë këto”, edhe u ktheva në Kosovë.

Sot nganjëherë më shkon mendja pse jemi katandisë mu në këtë moment kur po bisedojmë sot, a ka pasë të drejtë ai profesori kur ka thonë, ai mund të ketë pasë drejtë. Po unë përsëri thom që nuk ka pasë të drejtë edhe unë po thom edhe një mijë herë sikur të kisha qenë atje edhe një mijë herë kisha vendosë me u kthy në Kosovë. Se unë kom pasë rastin me shku edhe me shku në këto vende nëpër botë shumë kam shetitë, kom pasë rastin me jetu atje edhe me jetu shumë mirë. Por edhe pse në Beograd ma dhanë edhe banesën ma ofrunë, ma ofrunë banesën, ma ofrunë vendin e punës edhe studion, por unë asnjëherë nuk e morra edhe u ktheva në Prishtinë.

Erëmirë Krasniqi: Ishin dhjetë vjetë diferencë prej momentit që keni shku dhe u kthyet prapë në Kosovë. Çka gjetët, qysh e gjetët vendin edhe çfare ishin risitë e asaj kohe meqenëse Kosova tash e kishte një gjeneratë të arsimume?

Shyqri Nimani: Ka qenë (kollitet), ka qenë shumë diferencë e madhe, pra diferenca ka qenë edhe ma e madhe sesa kur e kom lënë Kosovën. Për arsye se në atë kohë kur kom shku unë në Beograd, ishin vitet, vitet e ‘60—ta edhe atëherë Jugosllavia u fut në, u bë një nga prijëset, sepse kryetari i Jugosllavisë Tito në atë kohë, Naseri edhe Nehru i Indisë ata u bënë udhëheqës të Botës së Tretë. Domethanë vendet e painkuadruara edhe përfitonte Jugosllavia shumë edhe në atë kohë Beogradi

zhvillohej me të madhe, çdo gjë ndodhte në Beograd, bëheshin takimet në Federatën Jugosllave, Beogradi përfitonte shumë, jashtëzakonisht shumë edhe u pat' zhvillu me të madhe.

Kështu që kur u ktheva unë në Prishtinë, Prishtina nuk kishte universitet, kishte një Shkollë të Lartë Pedagogjike, nuk ishte e zhvillume i kishte ndoshta 400 mijë banorë, kishim shumë pak. Edhe unë isha i pari magjistër atje, në Jugosllavi e le mo këtu, këtu nuk kishte fare, edhe atëhere hina në Shkollën e Lartë që e përmenda edhe e themelum më 1970 e themelum universitetin, që ishte një ngjarje jashtëzakonisht e madhe. Mandej mas tri—katër vjetësh e themelum edhe Fakultetin e Arteve që quhej Akademia e Arteve edhe fillum me seksionin e pikturës, të grafikës edhe të dizajnit grafik. Unë e udhëhoqa këtë katedrën e dizajnit grafik dhe atëherë filloi një zhvillim mjaft i mirë, filluan... i Kosovës, se u kthyen gjeneratat për çka kishte investu Kosova, gjenerata ime edhe do para meje filluan të kthehen në Kosovë që ishte gjë e jashtëzakonshme shumë gjë e mirë.

Edhe atëherë filluan të themelohen institucionet e para të Kosovës. I dini cilat janë ato? Me teatër... edhe pse disa ishin edhe ma heret. Mirëpo filluan me marrë domethanë karakterin ma të fuqishëm edhe me u, me u formu shumë ma mirë dhe mandej filloi me u ndërtu Kosovafilmi, mandej Galeria e Arteve, mandej [Ansambli] Shota e këto tjera. Pra filloi Kosova ta merrte trajtën e një shteti domethanë i cili do të vijë me hatër apo, që thojnë, a me zor edhe pse ajo ndodhi me këtë të dytën. Meqë nuk e kuptonin, domethënë Serbia nuk e kuptonte që ishte mbarimi i shekullit XX, që mo nuk ka hapësira në Ballkan, e lëre më në Europë, nuk ka ku dikush mund ta ta sundojë tjetrin edhe atëhere dihet çka ndodhi normal. Shqiptarët nuk mundëm mo me duru edhe pse durum dhetë vjet domethonë me lëvizje paqësore me humbje të mëdhaja, me vujtje të mëdhaja. Na majtëm universitetin, domethanë pa të holla edhe populli dha shtëpitë e veta.

Pra, çdokush në Kosovë, domethonë, prej njeriut ma të thjeshtë, deri te intelektualin ma i lartë, të gjithë e kanë dhonë kontributin e vet. Dhe askush nuk ka të drejtë asnjherë dhe për asnjë kohë të thotë që “Unë, unë”, por gjithmonë kemi me thonë, “Na”. Sepse, pa atë harmoni, pa atë monolit që e tregoi populli i Kosovës, të gjithë u bënë një, e për atë edhe fitoi Kosova. Për atë edhe bota e çmoi, domethonë, këtë vullnet të jashtëzakonshëm, këtë vullnet të një populli liridashës i cili kurrë në historinë e tij nuk ka shkelë popuj të tjerë. Kurrë, asnjherë. Sa e di unë historinë, asnjherë nuk dihet. Atëherë, veç që ka luftu për lirinë e vet. A lufta për liri nuk është, nuk është... domethonë, lloj krimi apo shkelje një populli tjetër.

Kështu që, atëhere, atëhere me të vërtetë filloi Kosova me e marrë... U pjek vetëdija, u ngrit shumë. Dhe krejt ato aspiratat e popullit tonë për këto, mund të them njëqind vjet sa ishim ne nën sundimin Jugosllav, ishin praktikisht 90 vjet, atëhere e arriti atë që duhej arritë. Pra, Kosova u çliru dhe sot ne duhet të luftojmë që këtë liri ta shndërrojmë në, në një, në një mirëqenie. Se po thojmë demokraci... se nganjherë demokracia, nganjherë të duket që është anarki. Por, ta krijojmë një mirëqenie që së paku shumica e popullit tonë ta ketë jetën e dinjitetshme. E jo që dikush të ketë tepër, dikush të merrë paligjshëm, e dikush të vuajë. Edhe kjo, na dhemb neve të gjithëve kur themi që në Kosovë, domethanë, një njeri i varfër i harxhon një dollar e diçka në ditë. Dhe kjo është shumë e dhimbshme. Këto, secili prej nesh në Kosovë kur të shkojmë me fjetë, kur jemi qetë duhet të mendojmë pse është kjo edhe çka mundemi ne me ndërru në këtë drejtim?

Me gjithë këto përparime, që domethonë, iniciativa shumë pozitive nga të cilat, nga ajo që ëndërrohej që duhet bërë, arrihej një përqindje, por ishte shumë larg asaj që duhet me qenë normale. Sepse na nuk kishim asnjë hapësirë që të krijojmë, domethanë, qeverinë tanë të mirëfilltë, t'i krijojmë institucionet e kulturës, të arsimit, të cilat janë fundamentale dhe të mendojmë të bëjmë projekte se si duhet të krijohet një shtet i mirëfilltë demokratik. Ajo ishte shumë e vështirë, por është me randësi që neve na shtynte diçka e brendshme, diçka kishte fillu.

Une e mbaj në mend kur vijshin ambasadorët që ishin të akreditum në Beograd, edhe sa herë që vishin herën tjetër, unë kam pasë rastin me ndëgju që thoshin, "Po gjithmonë po shohim diçka të re te ju. Po ndërtohet. Po zhvillohet diçka. Po ndodhë diçka". Edhe kjo, kjo ishte e dukshme, për arsye se kjo ishte një vullnet shumë i madh, jo vetëm i institucioneve, për arsye se ne kemi pasë ata udhëheqësat të cilët, në qeverinë e Kosovës, të cilët, sidomos në këto institucionet arsimore, kulturore dhe shkencore, të cilët kanë qenë njerëzit e shkollum, kanë qenë në fushën e vet doktorë dhe me doktoratë. Pra, të cilët kanë qenë patriotë të mirëfilltë, të cilët kanë kriju vlera të jashtëzakonshme dhe me këtë vullnet të madh, ka kalu pra.

Thashë kur e themelua universitetin, mandej e themelua Galerinë e Arteve, unë isha, kështu deshi fati, drejtor i parë i këtij institucioni, dhe e kom udhëheqë dhjetë vjet... dhe ne kemi pasë planet tona. Edhe t'u marrë parasysh që në Këshillin Ekzekutiv, për shembull, edhe Ministrinë e Kulturës kanë qenë njerëzit tanë të cilët, të gjitha projektet tona të institucioneve të kulturës janë përkrahë, mjetet janë dhanë me kohë të caktume. Domethonë, institucionet kishin mundësi me këshillat e tyre që paraprakisht, domethonë për vitin e ardhshëm t'i ndanin mjetet, t'i përcaktonin projektet dhe i realizonin me dëshirën shumë t'madhe edhe me sukses. Pa kurrfarë problemi.

E sot është paradoksale, unë shoh për shembull shumë institucione me vonesa po i marrin, i marrin mjetet me kvartale [tre mujore], apo me vonesa, nuk janë t'mjaftushme. Edhe kështu i kanë pengesa institucionet, shumë kanë pengesa. Edhe kjo varet prej nesh, kjo nuk varet ma, nuk kemi pretekst t'themi që armiku ynë, apo jo, ai po na pengon... sot na jemi, nuk kemi pretekst. Çdo gjë që është e mirë, na takon neve merita, që është e keqe, gjithashtu na takon neve. Edhe për ate po them që u patën kriju, fillum... nuk kishim galeri. Bomë galeri, një, dy, tri galeri. Pastaj, fillunë edhe qytetet tjera Qendrat e Kulturës, në qendër kishin edhe galeri. Kështu që, arti figurativ filloi të, të zhvillohet. Pastaj, universiteti filloi të, Fakulteti Arteve, dega artit figurativ.

Erëmirë Krasniqi: A kishit shumë...

Shyqri Nimani: Më falni?

Erëmirë Krasniqi: ... studentë?

Shyqri Nimani: Si?

Erëmirë Krasniqi: A kishit shumë studentë?

Shyqri Nimani: Po. Nuk kishim shumë studentë në atë kohë. Domethanë, në degën e artit figurativ i pranonim dikun tridhetë e pesë vetë, dizajn i bartshim katër—pesë, në pikturë nja dhjetë, skulpturë nja dy—tre, grafikë dy—tre. Mirëpo, ata ishin të shkollum jashtëzakonisht mirë se kishim kohë me punu me ata studentë. A sot për shembull, si krahasim, i kemi për shembull, edhe, edhe universitetet private për shembull, i marrin ka 100, 150 studentë për shembull. Është e jashtëzakonshme, është tepër, apo jo? Edhe atëhere ata kur ta kryjnë fakultetin çka do të bëjnë? Do të mirren me diçka tjetër, absolutisht jo me fushën. Se është e pamundur ti ta mësosh një stu... me një klasë për shembull, ti mësosh katërdhjetë studentë për shembull... nëqoftëse i kemi nda nga dy klasë ka katërdhjetë, edhe atëhere ti, nëqoftëse i ki dy orë, domethonë duhet për secilin ka një—dy minuta me ia kushtu, që është jashtëzakonisht e... pak.

Mirëpo, fillum mandej na interesonin edhe, edhe librat nga historia e artit. Dhe atëhere na konkurum, Galeria, te Ministria e Kulturës, na ndau mjetet dhe e botum për herë të parë “Monografinë e Artit Bashkëkohor të Kosovës”.

Erëmirë Krasniqi: Po.

Shyqri Nimani: Edhe atëhere ne i angazhum domethonë, një historian të artit shumë t’mirë, Vlado Bužančić nga Kroacia, i cili pat’ ardhë këtu, i pat’ studiu artistët, por, edhe më parë... I angazhum katër artistë tanë për ta shkruar, për t’i shkruar tekstet për grafikë, për artet aplikative, për pikturën, për skulpturën... fotografët ma t’mirë... edhe e botum Monografinë në tri gjuhë, në shqip, serbo—kroatisht dhe anglisht. Kështu që, doli një Monografi që sot mund të them është një, është një Bibël se çdokush që ka m’u marr me artin e Kosovës ka m’u, ka m’u thirrë në atë... se e kemi punu me dashuri shumë t’madhe.

Kështu që, mandej fillum edhe me botu. “Rilindja” filloi... meqë në Jugosllavi ishte marrë ni iniciativë të botohen “Muzetë e Botës”, edhe atëhere edhe na në gjuhën shqipe u futëm. I botum nja gjashtë—shtatë. “Rilindja” i botoi. Janë shumë t’mirë, u botunë në gjuhën shqipe. Dhe mandej fillum edhe një numër i ynë piktorësh... se na e kishim një a dy historianë të artit... por, piktorët, disa piktorë, pra artistë tanë që shkruanin libra... unë i shkrova disa... i shkrova për shembull piktorët mesjetarë shqiptarë “Onufri dhe piktorët e tjerë mesjetarë”, mandej e bëmë atë “Monografinë e Artit Bashkëkohor” edhe libra tjera, mos t’i rendis tash... edhe kolegët e mi... Kështu që, fillum me e pasuru edhe bibliotekën e arteve figurative, jo vetëm botërore, po sidomos i kishim dhanë përparësi arteve, domethonë, vendore. Dhe kështu, kështu mendoj që kemi arritë. Mirëpo, tash Galeria e ka për detyrë që këtë ta çojë edhe ma tutje.

Erëmirë Krasniqi: E çfarë sistemi i arteve është instalu në Jugosllavi? Sistem në sensin se si i ka promovu artistët ndërmjet krahinave, provincave?

Shyqri Nimani: Po.

Erëmirë Krasniqi: Si janë distibu ide të caktume në art?

Shyqri Nimani: Po. Pra n'atë kohë, n'atë kohë, sikur që edhe fushat tjera, unë po flas për ata që e njohim fushën tonë, pra fusha e arteve pamore.... Kanë ekzistuar, pra, galeritë. Secili kryeqytet.... Se kanë qenë ato, sistemi Jugosllav ka qenë, Federata Jugosllave kanë qenë gjashtë Republika dhe dy Krahina Autonome. Edhe këto, megjithatë edhe këto dy Krahinat Autonome, domethonë Kosova dhe Vojvodina mas '74—shit kanë qenë gati si Republika, kanë qenë si, si njësi të barabarta të Federatës.

Kështu që, ne kishim takimet. E kishim ka një përfaqësues në Federatën Jugosllave, dhe çka hynte në Jugosllavi dhe çka dilte jashtë, na pajtoheshim. Edhe atje vendoshim cila ekspozitë ka me ardhë. Unë për shembull, une isha anëtar i atij Këshilli atje, edhe dëshiroja... për shembull, unë e pruna ekspozitën japoneze këtu për herë të parë, të Dagestanin³ dhe të tjera. Edhe atje mirreshin vesh, “Nji ekspozitë ka me ardhë amerikane. Ka me hi në pesë—gjashtë qytete”. Secili pranonte me e marrë edhe merrte pjesë me mjete për katalogun. Botohej në secilën gjuhë, secilën gjuhë. Ka qenë nji barabartësi, ç'është e vërteta reale.

Edhe atëhere, atëhere kanë ekzistuar edhe shoqatat, Shoqatat e Artistëve të Arteve Figurative dhe Shoqatat e Arteve Aplikative. Secila, pra, republikë e krahinë i ka pasë. Na në Kosovë i kemi pas tri shoqata. E para u pat themelua Shoqata e Artistëve Figurativë me kryetar Muslim Mulliqin. Mandej, u themelua Shoqata e Artistëve Aplikativë të Kosovës, unë, mu më patën zgjedhë kolegët kryetar. Edhe mandej e patëm zgjedhë, themelua edhe Shoqatën e Artistëve Figurativë të Prishtinës. Edhe ajo ka funksionu edhe ka qenë kryetar i ndjeri Kadrush Rama.

Dhe në këtë mënyrë ne patëm fitu, mjaft patëm fitu. Arti figurativ u pat' imponu, u pat' imponu. Bile, mu m'kujtohet njëherë ka ardhë akademik Ali Hadri... vishin në zyre, se na e kemi pasë Galerinë në, në Pallatin e Rinisë që atëhere quhej “Bora dhe Ramizi”, dhe aty kishim vizita të jashtëzakonshme se ishte mu në qendër. Edhe.... Bile ekspozita e arteve figurative të Shqipërisë ka pasë vizitat ma t'mëdhaja që ka qenë e regjistruar edhe në UNESCO, 40.000 për 20 ditë, 40.000 vizitues. Rendi ka qenë i madh. Vishin shkollat, se ato.... Ka qenë ekspozitë realiste. Dihet ajo soc—realizëm, mirëpo, nuk ka pasë shumë tipare soc—realizmi sa ka qenë figurative. Ka pasë figura nga historia e popullit shqiptar, e kështu.

Edhe, edhe në atë mënyrë filloi arti figurativ... që thashë erdh Ali Hadri dhe po m'thotë mu, “Nalu bre Shyqri, po ju Galeria jeni bo ma të popullarizim se Akademia e Shkencave!” Se aty, domethonë, hapeshin ekspozita. Vishin, për shembull, Televizioni i Prishtinës, tash që thuhet RTK—ja, po përpara RTP—ja [Radio Televizioni i Prishtinës] ka qenë... vinte, ata xhiroshin në gjuhën shqipe, vishin ata në serbo—kroatisht, vishin edhe ata në gjuhën rome, vishin ata në gjuhën turke... kështu që, çdo ditë në televizion ti i ke pasë ekspozitat që hapeshin në Galeri. Ka qenë ma e popullarizime.

Po sot, si është çështja sot? Sot është shu Shoqata, nuk ekziston, Artistëve Figurativë, Shoqata Artistëve Aplikativë, Shoqata e Prishtinës. Pastaj, njerëzit...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë funksioni kanë pasë Shoqatat, po mendoj me çfarë punë janë marrë?

Shyqri Nimani: Po...

Erëmirë Krasniqi: A kanë promovu artista, apo i kanë mbrojtë të drejtat e autorit, të drejtat autoriale?

Shyqri Nimani: ...po, po. Shoqatat, pra, e kanë pasë një gjë. Shoqatat kanë organizu, domethonë, e kanë pasë anëtarësinë e vet, kanë organizu ekspozitën vjetore. Dhe në Galeri, na ju kemi pasë dhanë secilës shoqatë një ekspozitë në vjet, domethonë, ato trijat e kanë pasë të garantume këtë. Na i kemi ndihmu shumë që ata mos të mirren.... Punimet iu kanë pranë këtu. Ata i kanë ba juritë e tyre, juritë seleksionuse, mirëpo punimet ju kemi pranë këtu. Kur janë kry ekspozitat kanë ardhë i kanë marrë. Kështu që.... Mandej Galeria filloi me ble. Na i blemë në atë kohë për dhjetë vjet 500 vepra. Filloi me u pasunu fondi i Galerisë jashtëzakonisht shumë. Dhe në këtë mënyrë arti figurativ pat' përparu.

Mandej shoqatat çka bënin tjetër? Organizonin edhe këto *workshope* [punëtori] të ndryshme, organizonin, një gjë që ishte shumë e mirë, këto, si po i thojnë? Po, në një herë n'vjet bojshin koloni artistike dhe kolonia artistike ishte shumë e bukur. Ose shkonim në Deçan, ose shkonim në Rugovë, apo ndoni hapësirë tjetër. Merrshin piktorët, artistët merrshin pëlhurat, merrshin ngjyrat, merrshin lapsat, letrat edhe jetonin shtatë ditë deri në dhjetë ditë... me ushqim me fjetje e kanë pasë. Ishin të detyrun me e lonë një pikturë që t'i vjen në pronësi Galerisë.

Domethonë, ishte një ambient shumë i bukur, takoh... i kanë pasë edhe zyret e tyre. Kurse sot, është për t'u dhimbsur. Zyret i kanë plaçkitë mas, i ka zënë tjetërkush mas '99—shës, mas luftës. Shoqatat, domethonë, për t'keqen e disa kryetarëve të cilët nuk ishin, domethonë, të përgjegjshëm, i kanë shkatërru. Fatkeqësisht janë shkatërru te tre shoqatat, nuk ekzistojnë. Dhe gjithashtu, nuk organizohen, nuk organizohen. Apo organizohen aty—këtu, në mënyrë private, mblidhen tre—katër vetë, pesë vetë, dej në dhjetë vetë, lypin të Ministria Kulturës, kërkojnë, për shembull, një, një, një, një buxhet të vogël sa për ta bërë një katalog të vogël dhe për ta çu një ekspozitë dikund tjetër.

Por, ende ka mbetë, domethonë, ajo katandisje. Fatkeqësisht që edhe Galeria, edhe në Galeri tash duhet të organizojë më në fund një ekspozitë madhore të artit figurativ të Kosovës në botën e jashtme. Me një monografi të bukur në disa gjuhë. Duhet të mbledhë vepra artistike. E dini që 20 e... apo të themi këto 17 vjet, por edhe ma herët, domethonë, nuk është ble asnjë vepër artistike dhe merreni me mend se sa dami iu ka bo Kosovës. Domethonë, këta piktorët e ri, gjeneratat e reja, kanë mujt me i shitë pikturat aty—këtu me pare shumë të vogla, e ato piktura kanë vlera.

E tash ka mbetë, domethonë, një hapësirë shumë e madhe për fajin tonë. Pra, për fajin e atyne të cilët, po e them udhëheqës, e për fajin tonë them për arsye se ne nuk e ngrisim zërin. Sidomos gjeneratat e reja. Gjeneratat e reja nuk duhet me pritë në gjeneratat e vjetra, ne që ta ngrisim zërin edhe për ta sot, se ata duhet të mësohen ta ngrisin zërin për të drejtat e tyre.

Pra, duhet patjetër që të krijohet fondi, të krijohet pra fondi në Galerinë e Arteve që të blehen, domethanë, veprat e reja të krijuesve tanë. Se sot, kemi krijues shumë t'mirë, me të vërtetë shumë t'mirë. Se kanë kalu gjitha këto vite edhe gjithmonë po vijnë, domethonë, artistë ma cilësor, e ma

cilësor. Ne gjithashtu kemi punu edhe kemi marrë disa atele. Ato atele kanë qenë t'vogla. Por, sot duhet kërku përsëri atele.

Dhe t'i kthehemi këtij rastit në Bardhosh. Në Bardhosh, për shembull, ka dhjetë vjet që e kemi marrë prej, prej Komunës së Prishtinës atë tokën. Trollin e kemi marrë. Mandej, janë dhanë 600.000 euro, janë dhanë 80.000 euro, janë dhanë, janë arritë pare të mëdhaja dhe tash po lexojmë që mbaroi. Tash duhet tokën ose me e kthi ose me kërku përsëri. E kemi hupë të drejtën, domethonë, kemi qenë neglizhentë. Domethonë, për dhjetë vjet nuk arritëm me e kry. Edhe është një, një... ajo hapësira bukur ka ardhë ka fundi.

Mirëpo, fatkeqësisht që nuk e morri fundin, se thuhet Finis Coronat Opus, fundi e stolisë veprën. Këtu fundi e prishi veprën. Domethonë, shkum atje para disa ditëve, unë nuk jom taku me ata kolegët atje. Domethonë, tash është pyetje, Prishtina, komuna e Prishtinës ka të drejtë sipas ligjit me ta kërku, apo na duhet me apliku edhe njëherë për trollin, edhe mandej me kërku edhe mjetet tjera për me përfundu. Ka metë edhe diçka. Edhe ni numër duhet pagu edhe vetë këta, autorët, më duket janë tridhjetë deri në gjashtëdhjetë.

Erëmirë Krasniqi: Ajo ka qenë tokë e destinume për...

Shyqri Nimani: Po po, për atele...

Erëmirë Krasniqi: ... atele?

Shyqri Nimani: Po, po. Ata, ata moti e kemi marrë. Ka dhjetë vjet edhe s'mundesh me mendu që sa shpejtë kalunë dhjetë vjet.

Pjesa e Tretë

Shyqri Nimani E tash edhe kjo ka metë shumë, fatkeqësisht mas luftës na nuk punum për me e ndërto një galeri moderne, pra një galeri të artit bashkëkohor, tash fjalën modern domethonë mos të lidhemi me ndërtesa të vjetra. Se na në Prishtinë nuk kemi kurrfarë ndërtesë të vjetër për shembull me ia marrë, sa herë shkoj në qytete të mëdha të Europës të Italisë them, veç një ndërtesë me marrë me pasë në Prishtinë na ishim lavdu çka kemi, për shembull. Mirëpo ne nuk kemi, na duhet ndërto muze të artit bashkëkohor, ajo është shpallë, është ba projekti dhe ajo ka mbetë sot e asaj dite, gjithmonë bisedohet, jo komuna, jo galeria, jo ministria e kulturës, jo nuk po dihet ku është vendi, ku është trolli, kjo është krejt e thjeshtë.

Unë i thashë edhe Artës, drejtoreshës së tanishme, kjo duhet ta ketë si prioritet për këto katër vjetët e para që e ka mandatin të luftojë për ndërtimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor ose të prishet kjo ndërtesë këtu të ndërtohet e reja ose të gjendet një vend ku ndërtohet krejtësisht e re, edhe tash ende po mendohet. Konkursi është shpallë edhe e ka fitu arkitekti edhe ekziston ai projekt, dikush thotë, "Ja po e marrin atë ndërtesën atje e cila është në qendër", pra ajo te Skenderbeu domethanë ku është përmendorja e Sken.... Ajo ishte shtëpia e mallrave, dikush thotë, "Jo, po e rrezojmë këtë, dikush jo

atë...” Pra unë thashë, “Nëse ne jemi të një zërit, ne të cilët i njohim këto fusha jo ata që nuk i njohin, por vetë të arteve figurative të kërkojnë”. Domethanë, një këshill, të krijohet një këshill dhe ata të, të kuvendojnë, pleqnojnë se çka do bëjmë për...

Është koha e fundit sot arti figurativ i cili ka qenë i pari, me vlerat ma të mdhaja edhe ma shumë ka të shkollum se të gjitha artet këtu, sot ka mbetë i fundit pak flitet për të. Kurse bravo ju qoftë, këta të muzikës, sidomos të muzikës kohë të fundit po ndërtojnë me, me projekte që po konkurojnë edhe po ndërtojnë festivale të muzikës serioze, shumë të randësishme këtu. Gjithashtu edhe këta të dramës, të filmit edhe ata po mundohen e po krijojnë, kurse tanët diçka po më duket edhe mes veti nuk janë bash mirë gjeneratat e reja, na nuk i kemi mësu kështu. Na jemi mundu të kemi një harmoni, kemi mbajtë Akademinë shumë mirë, me harmoni, s’kemi pasë probleme. Mirëpo sot duhet të kenë kujdes gjeneratat e reja, nëse ata nuk e çmojnë vetveten asesi s’kanë me i çmu të tjerët. Dhe këtu duhet, kjo është pikënisja, nëse na e çmojmë vetveten kanë me na çmu edhe të tjerët, e nëse na nuk e çmojmë njëri—tjetrin edhe branshën tonë, sa ma shumë që kemi artistë të mirë aq ma shumë ka me përparu arti i Kosovës dhe çdokush duhet me mendu në këtë drejtim asesi në destruksion.

Erëmirë Krasniqi: Historinë e Galerisë të Prishtinës që ma vonë është shndërru në Galeri Kombëtare, a kishit mujtë me na tregu, meqenëse ju keni qenë drejtor i Galerisë?

Shyqri Nimani: Si edhe një here se nuk morra...

Erëmirë Krasniqi: Historinë e Galerisë?

Shyqri Nimani: Po. Atëherë kur erdh... unë u ktheva ishte viti 1979 nëse nuk gabohem, besoj se nuk gabohem edhe atëherë u shpall konkursi për drejtor të Galerisë. Na konkurum disa vetë dhe unë u zgjedha drejtor i Galerisë edhe pse unë e kisha këtë, jepja mësim në Fakultetin e Arteve, isha shef i katedrës së dizajnit dhe i thashë unë zotit Pajazit Nushi që, meqenëse ishte zyrtari kryesor në Këshillin Ekzekutiv atje, thashë që, “Unë nuk mundem me lënë” thashë, “Akademinë, fakultetin”. “Jo, jo”. Tha, “Ti do ta mbash atë edhe këtë”. Kështu që unë për ato dhjetë vjet i kom mbajtë dy poste, jepsha mësim atje edhe këtu i kom pasë një e treta e pagës në Galeri. Mirëpo në atë kohë kanë qenë disa personalitete, edhe Ali Hadri ka qenë profesor në fakultet edhe ka qenë drejtor i Institutit, për arsye se nuk kemi pasë shumë kuadër edhe unë përsëri mendoj kanë mujtë me nxjerrë edhe tjetër kënd. Domethanë për drejtor të Galerisë ka pasë, po ndoshta ata kanë mendu që duhet të jem unë, edhe unë e kom udhëheqë dhjetë vjet Galerinë.

Atëherë ne zgjodhëm në Pallatin e Kulturës, që n’atë kohë quhej pallati “Boro dhe Ramizi” dhe fillim prej zëros nuk e... domethanë nuk kishim asgjë, mirëpo mbështetja nga qeveria e Kosovës ka qenë e jashtëzakonshme. Edhe atëherë unë, m’u desht me i kriju ato tri zyret, sallën me i ngjitë të gjitha këto elementet që duhet, sa është e mundur n’atë kohë, domethanë ndriçimin, pollucionin, magazinën për vepra për m’i vendosë veprat. Kërkova mjete çdo vjet për me ble vepra artistike, çdo artist që e kishte ekspozitën në Galeri unë ia botoja katalogun, unë jo, po na them se them kurrë nuk është mirë t’them unë po unë, në këtë rast si drejtor po flas me Këshillin Artistik. Ne i blenim domethanë dy

vepra, secilit artist ia kemi ble dy vepra, s'ka ndodhë ajo mos me ia ble dhe ia kemi ble me mjete t'mira me një masë çfare ishte në ish—Jugosllavi.

Pastaj botonim katalogun e tij në tri, në tri gjuhë dhe me ngjyra posterin, pastaj i ftoja unë e kom pasë shti n'program edhe artistët kosovarë që jetojnë jashtë Kosovës edhe i kom ftu krejt ata që kanë qenë me Gjeloshin e Karmon Fan Ferrin e Bahri Drançollin e të tjerët që kanë jetu jashtë. Edhe këtu ju kemi pagu biletën e aeroplanit me shku me ardhë, hotelin, shtatë ditë ushqime, fjetje, ia kemi ble nga dy vepra dhe kjo ka qenë diçka që ishin iniciativat tona, idetë tona dhe qeveria kurrë nuk i refuzonte. Prandaj unë edhe çuditë pse kjo nuk vazhdon tash, përse nuk i ftojnë tash artistët tanë që janë në diasporë, pse nuk e bojnë fondin për me ble vepra artistike? Pse nuk e bojnë fondin për me kriju atele? Se une e kom këtu, i kemi pasë bo projektet, i kemi pasë pagu arkitektët te Kosovafilmi, se tashti ku është KFOR—i ajo ndërtesa e Kosovafilmit.

U pata marrë vesh me drejtorin e Kosova Filmit të ndjerin Azem Shkrelin, që aty t'i punojmë edhe dhjetë atele edhe katër të parat i bamë, edhe katër ateletë, të gjitha ateletë kanë pasë m'u ba sipas... një për pikturë, një për skulpturë, një për grafikë, një për dizajn. Edhe ato i kanë pasë ka 50—60 metra, me nxemje qendrore që merrte prej Kosova Filmit, dhe unë mendoj projektet janë këtu, arkitekt ka qenë... ky... që tash gjithë këta emra domethanë Spahiu e ka mbiemrin arkitekti dhe na ia patëm pagu. Domethanë ia kom pagu honorarin, krejt projektet ekzistojnë edhe tjera, mundesh me shku m'i pa këto janë kështu që {tregon me duar}, kaq janë secili me milimetrikë, me ujë, me nxemje, me krejt mirëpo metëm t'pa organizum mas luftës. Mirëpo tash përsëri, kjo duhet Arta me... kur shlirohet ajo ndërtesë, vendi është, leja është edhe mujmë me kriju nja dhjetë atele jashtëzakonisht t'mira.

Erëmirë Krasniqi: E, a e përdorshit ju këtë pozicionin e juaj si drejtor i Galerisë në atë kohë për m'i promovu artistët kosovarë nëpër krejt Jugosllavinë?

Shyqri Nimani: Po, edhe këtë pyetje shumë t'mirë e ke bo.

Erëmirë Krasniqi: Si ishte ai komunikim me pjesët tjera?

Shyqri Nimani: Eh, tash na edhe si shoqata kur isha unë kryetar, na i çojshim ekspozitat me shoqatat tjera, kemi çu në Shkup, na i kanë pru në Shkup ata na jepshin Muzeun e Artit Bashkëkohor, a din çfarë muzeu është i Shkupit, i riu? Mandej i çojshim në Zagreb, çojshim në Beograd edhe me Galerinë, une kom pasë marrëveshje reciproke ta marrë, ma merr, jo me ta marrë e ti mos me ma marrë domethanë unë kam qenë i barabartë. Kush ka dashtë me bashkëpunu me mu prej Jugosllavisë ka ba, kështu që kemi bashkëpunu me Beogradin, me Zagrebin, me Lublanën, me Shkupin, me Sarajevën, me Novi Sadin. Kështu që, kemi pasë aktivitet të jashtëzakonshëm. Edhe për ty Erëmirë [i drejtohet intervistueses] është me marrë këtu janë tre, tre informatorë që i kom une edhe krejt i ke të dhënat aty, krejt i ki të dhënat për dhjetë vjet, krejt çka kemi pasë ekspozita ku kanë qenë, prej datës kaq, sa vizitorë kanë qenë, si u qujtë, sa vepra i kemi ble edhe kom qenë shumë transparent se gazetarët sa herë kanë dashtë e kanë marrë. Sot për shembull nuk po e dijmë për shembull, jo vetëm këtu, po i ke pa televizionet...

[Intervistuesja e pyet folësin se si kanë filluar të shkruajnë për art, ta definojnë gjuhën. Pyetja është prerë nga video—intervista]

Erëmira [i drejtohet intervistuesës] pytjet, këto janë pyetje më të vërtetë të jashtëzakonshme se janë ngjarje të cilat kanë ndodhë me një hapësirë çfare ishte Kosova, mjaft e mrapambetur sidomos për këto domethonë fusha elitare të, të domethanë të mirave shpirtërore të njeriut. Pra ne nuk kemi pasë kur kemi filluar të shkrujmë në studime, në hapësira jashtë Kosovës për shembull në Beograd, Zagreb i përmenda, Sarajevë, Lublanë atëherë një numër jo i madh, i vogël prej nesh kemi shkru. Kemi fillu të shkrujmë, të shkrujmë për ato ekspozita që kanë ndodhë në ato qytete dhe unë për vete kam fillu që në vitin e dytë të studimeve, se kisha shumë ekspozita në Beograd. Thashë 20—30 ekspozita ishin t’hapura t’njëjtën ditë edhe shkruaja për “Rilindjen”.

“Rilindja” ka qenë gazeta jonë, në fillim ka qenë botohej një herë në javë, mandej një herë, dy herë, mandej e përditshme u bë dhe atëherë ishte ditëve të shtuna. Atëhere botoheshin sikurse edhe sot që tradita vazhdon, “Koha Ditore” apo “Zëri” ku botohej, domethënë shtojca është kulturore. Botojnë tema nga fusha e artit figurativ, filmi, muzika, drama, letërsia. Bile “Rilindja” ka pasë dy herë në javë botimin e tregimit të shkurtër që tash fatkeqësisht sot ka humbë, ku është botu një ditë është botu tregimi i shkurtër origjinal i autorëve shqiptarë dhe një ditë tjetër ka qenë i përkthyer nga letërsia botërore. Dhe kështu që unë kam pasë fillu të shkruaj edhe xhiroja edhe me Televizionin e Prishtinës i cili ishte në kuadër të Beogradit, na e kishim atëherë një herë në javë. Në fillim e kemi pasë një herë në muj, gjysëm ore, mandej është bë një herë në javë edhe unë merrsha kamerat e tyre edhe shkoja i xhiroja edhe i jipja edhe në televizion, përndryshe edhe i shkruaja për “Rilindjen”. Ka qenë “Rilindja”. Mandej ishte edhe revista, mandej filloi të botohej revista letrare “Fjala”, ka qenë format i madh, dhe “Fjala” ka arritë një nivel shumë të lartë për arsye se e udhëheqnin domethanë letrarë, profesionistë. Botohej poezia, studime të gjata për poezinë, për prozën, portrete të shkrimtarëve të ndryshëm, ese mbi letërsinë dhe ne botonim ese për arte figurative.

Kështu që, këtu ka fillu, kjo ishte ajo, domethënë ishin hapat e parë që dikush nga ne që mirrej mandej edhe me... meqë kishim studiu historinë e artit na kishim njohuri. Pesë vjet në Shkollën e Mesme të Arteve në Pejë, edhe pesë vjet në Beograd i kishim vizitu të gjitha këto monumentet kulturore, qofshin ato ortodokse, katolike apo muslimane me xhami e me kisha, me manastire si në Serbi, Maqedoni, Kosovë, Shqipëri e në Greqi, edhe i lexonim librat e shkrimtarëve më të mëdhej Llazarevit edhe të tjerëve të cilat ishin shkruar në gjermanisht, frangjisht, italisht apo edhe rusisht. Se e kishim na bibliotekën mandej të madhe në Fakultetin tonë se na kishte dhanë edhe biblioteka e Akademisë të Arteve e Beogradit, na kanë dhuru shumë libra nga historia e artit në gjuhë të huaja. Kështu që, edhe biblioteka jonë ka qenë shumë, shumë e pasur. Edhe e kemi pasë një historiane të artit Alltëne Taipi, ajo ka qenë aty domethanë si bibliotekiste ka qenë shumë, shumë vajzë e sjellshme edhe e zoja edhe ka shkru. Kështu që, në këtë mënyrë ka fillu pra, mendoj në mënyrën më t’mirë prej ma t’lehtës deri ka ma e vështira pra, nga një skicë e vogël për gazetë deri te një libër i historisë të artit.

Erëmirë Krasniqi: A kishit problem m’i përkthi termet specifike të fushës? Termet specifike të fushës që ishin... që natyrisht i lexojshin në gjuhën serbe, a e kishit problem me i përkthi se po mendoj njëfarë forme e kanë kërku prej juve njëfarë guximi intelektual me vendosë qysh ka me u qytë diçka?

Shyqri Nimani: Po, unë për veten time kështu, unë po flas për veten time edhe mendoj që unë kur flas për veten time, unë nuk jam rast i veçantë se ka pasë, gjithkrah ka njerëz të tillë, dikush—dikush është i ka ato mundësi. Unë për veten time nuk e kam pasë të vështirë për arsye se na në gjuhën shqipe nuk kemi pasë asnjë libër në gjuhën shqipe, ma në Shkollë të Artit në Pejë fare edhe në Akademi në Beograd atëhere hiç nuk ka pasë, tek kur kemi ardhë në Prishtinë i kemi fillu ato që i përmenda. Fillova unë t'i botoj librat edhe ata librat "Rilindja Në Muzetë e Botës" që u botunë për shumë gjuhë të Europës se përpara nuk ka pasë. Unë që në Shkollën e Artit e kisha përmendë edhe ma herët që unë pos shqipes, serb... serbishtën ma e kom si gjuhë, shumica prej nesh si gjuhë amtare. Unë edhe në Shkollën e Artit në Pejë vitin e pestë serbisht e kom pasë pesë, domethanë e kom, e kom njoftë atë gjuhë, prej moshës shtatë vjeçare kemi fillu në Prizren dhe kemi folë edhe shqip edhe serbisht edhe turqisht bile, edhe turqishten e kemi folë apo jo?

Mandej domethënë e kemi mësu anglishten, frengjishten dhe sa i përket literaturës në, në serbisht, në kroatisht ajo është sikur shqipja absolutisht nuk kom, kurrë s'kom pasë probleme se i njoft jashtëzakonisht mirë edhe kom përkthi libra. Pra kom përkthi libra edhe nga serbo—kroatishtja edhe nga anglishtja, edhe tekstet e mia jonë përkthi gjithashtu edhe në gjashtë—shtatë gjuhë botërore deri, deri në arabisht atje. Edhe tash nuk ka qenë e vështirë absolutisht ato t'i përkthej, apo t'i hulumtoj, t'i marrë informatat edhe mandej edhe italisht, kurrëfarë problemi. Domethanë italisht ishte për mënyrë shkencore e shfrytëzoi latinishtën gjithash tu, frengjishten gjithashtu, kurse serbishtja, anglishtja i kom si gjuhë, si gjuhë... e kom studiu edhe japonishten me njoftë si strukturë, kom qenë edhe në Greqi me njoftë greqishten në kurs një mujor edhe atje. Greqishten e vjetër sidomos se kom dëshirë me i lexu tekstet e vjetra domethanë të piktorëve shqiptarë dhe aty nuk kam kurrëfarë problemi.

Kështu që, nuk e kom pasë kurrëfarë vështirësie edhe sot nuk e kom kurrëfarë vështirësie t'i përdori. Në shtëpi i kam sigurisht një 20 fjalorë, domethanë të gjitha këtyre gjuhëve secila me secilën edhe sot e kemi edhe shumë mirë se tash me anë të internetit mundem edhe me Google, mundesh me pa me krahasu ndonji fjalë, i kom fjalorat e Oxfordit, domethanë që gjithmonë mundem me edhe fjalë të cilat fjalorët latinisht, fjalorët greqisht, fjalorët japonisht, fjalorët frengjisht, sllavisht, rusisht krejt këta fjalorë, spanjollisht, krejt domethanë i shfrytëzoj. Për arsye se baza e këtyre gjuhëve latine edhe këto anglofone edhe këto latine shkojnë si ta njofësh njëri. Domethanë nuk ka problem të tjerat se bazat i kanë t'njejtë nuk ka kurrëfarë vështirësie, a të folurit, të folurit është tjetër gjë, të folurit nuk mund t'i flas njeri gjithë ato gjuhë.

Erëmirë Krasniqi: E përmendet pak për koleksionin e Galerisë deshta për me tregu që çdo herë i keni nda dy copa edhe keni pasë po ashtu buxhet për krijim e koleksionit. A kishit mujtë me na tregu si keni, si ke vendosë çka është e vleshme, çka nuk është në njëfarë mënyre? Si e keni establishu atë farë standardi?

Shyqri Nimani: Hëm....?

Erëmirë Krasniqi: Qysh e keni establishu çka është me vlerë, vepër e artit me vlerë dhe çka jo edhe çka meriton m’u prezentu edhe çka jo? Diqysh me na folë pak për këtë logjikën pas koleksionit?

Shyqri Nimani: Erëmira edhe një herë duhet me thanë i ke pytjet e jashtëzakonshme. Kjo është diçka që është shumë qenësore, pse është, pse unë kom vendosë? Me të vërtetë është pyetje shumë qenësore. Unë një e kom pasë me qenë i sinqertë, një e kom pasë si detyrë, e kom lexu për shembull një tregim shumë të bukur të Servantesit edhe më ka pëlqy jashtëzakonisht shumë atëherë kom thanë pse atëherë ai nuk është i përkthym në gjuhën shqipe, pse mos ta përkthej unë t’ia çoj “Rilindjes” që edhe bashkëatdhetarët e mi të kënaqen. Për shembull, kom lexu tregime ku kanë të bëjnë edhe për... të shkrimtarëve të mëdhenjë diçka, edhe për shqiptarët.

Njihërë, për shembull më ra në dorë mu, lexova që Hemingway tonë e dijnë që ka shkru romane, por kërkush nuk e di që ka shkru poezi, edhe kur kishte qenë i ri ai në studimet e veta ka shkru poezi edhe ia kishin botu një libër me 88 poezi. Edhe unë e mora atë lajm i thashë drejtorit amerikan, i Qendrës Amerikane në Beograd se me ta kom pasë gjithmonë lidhje se vishin këtu gjithmonë, thashë që, “Kur të shkosh në Amerikë gjejma këtë libër”. Edhe ai ma gjeti dhe ma pru edhe e hapa me lexu, më interesonte Hemingway si ka shkru poezitë ai, edhe është diçka e jashtëzakonshme ky nuk është vend me, me... ndonjihërë mund të bisedojmë mes veti... Edhe atëhere po e shof Beteja e Kopenhagës është një poemë e gjatë edhe aty përmendet se n’atë betejë që kanë marrë pjesë, është betejë historike, por kanë marrë pjesë shumë popuj edhe me një vend aty flet për tokën e shqiptarëve edhe kjo ishte diçka e jashtëzakonshme. Unë thashë, pa e përkthi këta, le te lexojnë shqiptarët që Hemingway po na përmend neve, tokën e shqiptarëve që kanë luftu në Kopenhagë, në Danimarkë. E të tilla, të tilla.

Për shembull, Peter Ustinov e thotë për shembull, i huaji në Spanjë tregon që në kohën e... qysh ka dalë prej një anije spanjolle, prej një anijes të Shqipërisë prej një nëndetëse ka dalë në bregun e Spanjës, e kanë gjetë ata dhe e kanë pytë “Kush je ti?” “Shqiptar, Albanese”. Ai e thotë krejt çka dinë, ai nuk di gjë tjetër edhe mendojnë që Rusia me ato nëndetëset unike ka dashtë me, me shpiunu atje. Por tregimi i gjatë plot humor është shumë i mirë edhe ato kom dashtë gjithmonë une me i... mirë po mendoj kur e kom pa se në historinë e artit nuk kemi libra, nuk kemi libra në gjuhën shqipe atëhere kom thanë unë pse mos t’i bëjë unë ato, tjetër kush nuk po i bon askush, në Shqipëri jo se jo, se në Shqipëri s’i kanë përkthi ata prej gjuhëve t’huja, kanë bo disa libra mbi artin bizantin shqiptar, une i kom ato të gjitha edhe ka qenë shumë pak, kurgja, zero n’krahasim me popujt e Ballkanit.

Edhe atëhere unë dalë—ngadalë kom fillu edhe ato kom fillu m’i bo n’mënyrën, ama shumë luksoze, nuk kom dashtë m’i bo sa për sy e faqe, kom dashtë m’i bo jashtëzakonisht mirë baraz me ato që botohen në Evropë. Edhe kështu kur e punova librin “Onufri dhe piktorët e tjerë mesjetarë shqiptarë” i ki pesë kopje këtu, mundesh me i kqyrë në bibliotekë edhe 2000 kopje u shitën. Shqipëria e pritën ata n’mënyrë të jashtëzakonshme se ata i kishin bo ni libër që e ka bo Theofan Popa, një bizantolog i madh shqiptar, mirëpo ai nuk e dinte estetikën, e dinte hagiografinë, i dinte zakonet edhe doktrinën bizantine, libër i vogël.

Edhe ma dhanë këta të “Rilindjes” bardh e zi i shtypun, “A po lexon, a po mendon që nëqoftëse është mirë po e botojmë, shkruja parathënien”. Unë ia bona parathanien, por i thashë që ky libri i ka rezolucionet e dobëta, të zeza, shtyp i lartë, klishetë e këqija... “Mirë”, thanë, “Çka po propozon?” Thashë, “Ta bëjmë një me ngjyra, të ri po, ngjyrat”. Thashë, “Duhet me i marrë në Shqipëri. Pikturat me ngjyra, sllajdet”. Edhe atëhere vinte Dhorka Dharmo këtu i thashë, “Dhorka, a po i shkrun ti?” Ajo bizantologia jonë, “Jo”, tha, “shkruje ti”. Kur m’tha edhe ajo, insistoi, atëhere m’i çunë prej Shqipërisë sllajdet e bukura, çka bona unë i mora i çova m’i shtypë në Zagreb, jo në Prishtinë. Në Zagreb ka qenë një shtypshkrojnë private edhe ai Kreshimiri ia dha disa murgeshave sllovene sllajdet që ia çova që dojsa me i shtypë te ai në Slloveni. Ato i kanë nda ngjyrat, edhe qysh i kom dashtë une ato figurat me i nxerrë disa elemente ku i kom ba një homazh Onufrit edhe ato i kanë punu.

Atëhere kesh n’panair të Zagrebit erdhi drejtori i “Rilindjes”, Agroni më tha, “Të lutem Shyqri m’i bjer”. Se i bleva letrat une krejt atje se isha totalerist, kërkush s’mund të m’i ndalte mu iniciativat pozitive hiç. Na kanë përkrahë këtu. Kjo [Arta] po m’tregon këta nuk e njohin këshillën, qysh drejtorit me ia ndalë të drejtën Këshilli? Këtu nuk e lejojnë kurgjo me ba këtë, m’tregoi këto ditë. Që dy mujë që ka fillu edhe këtu i pengojnë. Unë e kom marrë këshillën, por Këshilli nuk mundet me qenë mbi drejtorin, Këshilli e ka një herë takohet i tregon ato. Ditën e mirë! Drejtori ka me realizu gjithë ato, drejtorit i takon e mira e keqja.

Edhe ai m’tha e pruna “Rilindjen” këtu e bleva letrën në Vebedo, letra mat për me i punu, kqyr çka kom punu unë për me bo librin? Kur u botu libri në Shqipëri e kanë marrë, e kanë vlerësu jashtëzakonisht se 2000 kopje këtu u shitën menjëhere e as unë s’kom, qe këtu jonë, këtu janë m’duket tri a pesë kopje që ia kom dhuru unë këtuhit dhe tash as unë s’mund e marr. Po unë tash do ta ribotoj, vitin tjetër do ta dizajnoj n’këtë formën e këtij, kësaj monografije e do ta çoj në Shqipëri se ata s’e kanë fare. E tash, kur e morrëm na e botumë atë edhe Kadareja në revistën “Di Lettere Albanese”, “Letërsia Shqiptare” aty 20 faqe i përkthym në frengjisht për Onufirin. Domethanë shumë e kanë, ju kanë lanë përshtypje edhe prej atij libri mandej kom vazhdu unë, deri tash i kom nja 20 monografi domethanë që kam punu, secili t’i lypë tre—katër vjet, pesë vjet edhe kështu kom fillu unë.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me na tregu ma shumë për krejt këto ndryshimet politike qysh e kanë ndiku skenën e artit?

Shyqri Nimani: Tash, do të thotë që pas vdekjes së president të Jugosllavisë Josip Broz Tito, i mirë e i keq ka bo t’mira ka bo edhe t’këqija se kur është dikush në udhëheqje aq shumë vjet normal që mundet me bo gjëra t’mira po edhe gjëra shumë t’kqija. Pavarësisht ajo është çështje tjetër. Atëhere erdhën në fuqi serbët, domethanë serbët e pritshin atë moment që kur të vdes Josip Broz Tito atëherë atyre do t’iu dahet rruga që ata ta sundojnë Jugosllavinë dhe ky ishte gabimi ma i madh i serbëve për arsye se serbët për njëqind vjetët e fundit janë rritë prej pashallëkut të Beogradit që ka qenë vend i vogël Serbia, shumë i vogël pa Vojvodinën, pa Kosovën. Edhe është rritë është bë aq e madhe sa që në federatën Jugosllave ata e sundonin 70 përqind me oficera dhe me gjeneralë edhe, edhe në këto...

Domethanë ishin zhvillu jashtëzakonisht, pse ata iu, pse atyne iu pengoi? Tashti... domethanë që shqiptarëve me ua marrë edhe ato çka e kanë. Se shqiptarët ndash me t’mirë ndash me t’keq, shqipëtarët duheshin me ardhë këtu ku janë sot, po t’i lejonte Serbia m’u zhvillu sikurse

zhvilloheshim, ata e dinin se shqiptarët kanë m'u zhvillu aq shumë sa që një ditë kanë me ditë me qenë të pavarur apo jo? Ai tha, “Do ta shfrytëzojmë, e kemi armatën, do ta shfrytëzojmë ushtrinë tonë, kemi këtë rast historik edhe na duhet me i shkelë ata me dhunë”. Edhe na morrën, dihet kur ishte mbledhja thanë, “Jo, na nuk e dojmë domethanë kushtetutën e ‘74—tës”. Thanë, “Jo”. Domethanë, “Na po dojmë m'u shkri, nuk ka nevojë, po jemi n'kuadër të Serbisë”. Edhe me dhunë domethanë ata e shkarkun domethanë, i shkarkun kompetencat që i kishte Kosova deri atëhere.

Mandej ne fillunë me na i ndalë universitetin, na qitën prej Universitetit, mandej fillunë vetëm me i lonë shkollat fillore. Kështu që, atëhere erdhi momenti që shqiptarët u mbështetën për mur. Edhe e para gjë me me ba, duhej një lëvizje paqësore aktive me Lidhjen Demokratike, u shfaq për herë t'parë Lidhja Demokratike po del një parti shqiptare. Për herë t'parë po del në legalitet, se në ilegalitet Serbia, Jugosllavia i ka shkatërru t'u i shti nëpër burgje se gjithmonë padiste që po donë me shkatërru shtetin edhe krejt republikat tjera, a po e shkatërron shtetin, “Myte, fute në burg!” E atëhere doli Lidhja Demokratike, kjo ishte një lëvizje shumë e madhe dhe një potez i jashtëzakonshëm. Pra në krye me Ibrahim Rugovën edhe ajo qe një gjë shumë e madhe dhe atëhere ata mujshin me, me i kërku n'mënyrë demokratike të drejtat edhe Serbia nuk mundej tash me zor... mirëpo atëhere ajo filloi me na i marrë me dhunë, na qiti prej universitetit, na i morrën ato arritjet edhe atëhere...

Erëmirë Krasniqi: Si ju...

Shyqri Nimani: Urdhno?

Erëmirë Krasniqi: A u dorëzu naj vendim a qysh e bonën?

Shyqri Nimani: Si?

Erëmirë Krasniqi: Si ju largunë prej Galerisë edhe prej universitetit, a kishit mujt me na tregu?

Shyqri Nimani: Galerinë lehtë e kanë marrë, por prej universitetit se... Tash ata thanë, ata thanë që sipas rregullave të tyne minoritetet kërkund n'botë nuk kanë universitete e kësi gjëra, “Ju i keni tepër prandej ju duhet me iu privu, me hatër, me iu hekë”. Mirëpo, shqiptarët natyrisht nuk e pranojshin këtë temë sa na nuk ishim minoritet, na ishim në tokën tonë, na ishim përkundrazi nuk ka tokë ma t'pasur se Kosova domethanë i ka 92 përqind shqiptarë. Shqipëria i ka 95 këto janë dy, dy shtete që kanë domethanë tash edhe UNMIK—u që po na bon edhe këta tash po thojnë shtet multi—nacional, multi—etnik, ku është multi—etnik nuk e... Serbia nuk është, 40 përqind nuk është serb në Serbi edhe nuk çajnë kokën për tjerët edhe kanë flamurin e stemën e kanë edhe, edhe himnin kjojnë vetëm për Serbi, nuk kjojnë për tjerët. Po bota është e padrejtë kur nuk e shliron ti vetvetën atëhere pak t'japin ata.

Edhe atëhere neve na erdhën, çka na thanë? Ishte vera, si na qitën për shembull neve prej Fakultetit të Arteve, ishte vera, ti e ki këtë monografinë time dhe ke me lexu mirë, ta jap unë vjen brenda dhjetë ditëve, aty unë i kom spjegu krejt këto ngjarje dhe aty i ke, shumë gjëra ke me lexu në këtë monografinë time, po.... Tash atëhere, erdhi vera, erdhi vera, pushimi veror e ata na i prunë masat e

dhunshme kështu i kanë quajhtë, a di, masat e dhunshme ku u heqën krejt shqiptarët çka kanë qenë dekanë e prodekanë, rektorë i hoqën edhe i qitën serb. Tash unë e Muslim Mulliqi, i ndjeri, na thirri Shqipëria Akademia e Arteve për me shku në diplomat e tyre edhe morrëm na hajde kon po qesim në dekan, e qitëm ni Zoran Karalejić⁴, ai ka qenë kërkushi, e kemi rritë, e kemi shkollu, e kemi bo edhe ia kemi dhanë fakultetin, e kemi bo magjistër në skulpturë edhe plus e kemi bo dekan.

Edhe ai po na thërret mu e Muslimin, shkum unë e Muslimi atje, u kthym prej Shqipërisë, ai na dha dokumentin për SUP, për Sekreat të Punëve të Brendshme që jemi thirrë atje që jemi thirrë atje, edhe me na dhanë ata me na leju se thojke ai, “Duhet vizë me marrë me shku në Shqipëri”, edhe na... atëhere tha, “A e keni vizën e Shqipërisë?” Se e kishin pru atë shefin e policisë prej Beogradit, “Jo more”, thashë “Shqipëria na ka thirrë neve s’ka nevojë viza me shku”. “Atëhere”, tha “duhet me marrë vizën ju”. “Ku me marrë vizën?” “Në Beograd”. “Në Beograd? Po ne edhe dy ditë duhet me qenë në Tiranë”. Edhe atëhere ai tha, “Jo, kështu është”. Thashë, “Kurgjo. Ditën e mirë!” Shkova poshtë e morra unë atë dokumentin edhe unë e Muslimi u nisëm n’makinë i ramë nga Maqedonia, hinëm në Greqi me makinën teme, se m’tha Muslimi, “Kanë me ta thy makinën nashta”. Ma thynë në Shqipëri nime makinën se i vjedhshin ato pasqyret për nuse s’kanë pasë shofershajbne ata dej ato.... Edhe shkum unë e Muslimi e morrëm atje.

Edhe kur u kthym ai po na qet’ prej pune tha, “Pa leje”, edhe na paditën, na qitën me rend, ma së pari unë shef i Katedrës së Dizajnit, Muslimi të Pikturës, Agimi [Çavdarbasha] i skulpturës, atë tjetrin edhe sekretarin. Shtatë vetë të parë na qitën prej fakultetit. Madej fillunë edhe tjerët deri sa i qitën të gjithë. E unë atëhere dhe Muslimi vendosëm me i paditë, domethanë Akademinë edhe e morrën një avokat, ai e mori avokatin unë jo, unë thashë, “Mbrohna vet”. Edhe fillumë na me, me shku, në ndërkohë Muslimi vdiq e unë vazhdova mos ta zgati shumë, edhe e mujta atë, atë gjykatësen e Beogradit edhe ajo çka boni, e pruni vendimin e pezullon procesin gjyqësor deri në kohë të pacaktume merre me mend sa e poshtër edhe tha po ma bon mu, “A je i knaqun?” Pasi e pruni vendimin, se edhe m’pyti mu tha, kur filloi procesi, “A po doni ju me pasë përkthysin shqip—serbisht?” “Jo”, i thashë, “unë i du t’gjithë me qenë këtu shqiptarë, unë serbishtën e njoh si ju po duhet me pasë shqiptarë, krejt jeni serbë domethanë kjo nuk është e drejtë”. Thashë, “Me serbisht”.

Kështu që, kanë qenë shumë të këqij, por unë kam qenë shumë i guximshëm a din, kur i thashë asaj kështu edhe më së mrami ma boni, “A jeni i knaqun?” “Jo”, thashë, thashë unë. Ajo m’tha mu, “Unë e kom zgjedhë, a din, jo mos me ju pranu juve ata”. Unë thashë “Ju e keni bo, me pasë mujtë mos me ma pranu, më ma hudhë poshtë ankesën atëhere ju e kishit bo, por kur e keni pa, se jeni e ndershme, besoj se unë i pata krejt dokumentet, të tregova që na verës nuk kemi me marrë...” lëshohemi tre mujë ditë në fakultet nuk ka nevojë me majtë, sikur në fakultete, [nuk është] sikur punët tjera që e merr ti 20 ditë pushim edhe ia çova dokumentin se i kishin mshefë ata që na i ka dhanë ky që na ka lëshu që thashë atë dokumentin ky dekani edhe atëhere ajo tha, “Jo, unë kom dashtë kështu”. “Jo”, thashë, “ju s’keni mujtë me m’kthy mu aty se unë i vetmi prej krejt shokëve t’mi me shku në atë akademi, nuk isha shku edhe miliona me më dhanë, veç kom dashtë me të tregu që kjo është domethanë një terror i paparë edhe e padrejtë e paparë ndonjiherë në histori”.

Dhe këtu u ndamë, atëhere na qitën krejtve neve, atëhere filloi populli domethanë me i dhanë hapësirat e veta, fillunë na m’i lëshu. Mirëpo unë sa u lirova prej Galerisë dhjetë vjet m’kalunë, se deshta me bo ata dy mandate e gjysë mandej shkova i thashë Pajazitit, “Unë duhet m’u tërheqë se shumë m’ka marrë kohë, shumë jom i anagazhum”. Edhe atëhere e qitën një konkurs edhe bash qetë Nebiun [Muriqi], bash këtë unë, e pranum, po ky e lëshoi menjherë, mas dy—tre mjuve e lëshoi, nuk ishte në gjendje s’di pse, por me konkurs unë e gjeta dhe ky i plotësoi kushtet ma së miri.

Erëmirë Krasniqi: Cilin vit ishte?

Shyqri Nimani: Po ky atëherë, tash vetë më kujtohet ‘79, ‘89, ‘90 qaty... vitet ‘90.... Edhe erdh mandej Xhevdet Xhafa, erdh te unë në shpi tha, “Më kanë thanë shokët”, tha, “a të kanë zgjedhë për m’u ba dekan i fakultetit?” Po thom, “Po une sa e lëshova bre këtë Akademinë”. Edhe e pranova m’u bo dekan i fakultetit dhe mandej tri vjet e kemi vazhdu ashtu edhe gjithmonë ma vështirë e ma vështirë e ma vështirë deri sa u duft me dalë UÇK—ja. Dhe filloi mandej, këto tjerat i din apo jo?

Erëmirë Krasniqi: A kishit galeri në atë kohë?

Shyqri Nimani: Po, Galeria punonte, Galeria punonte në atë kohë ka qenë drejtor i Galerisë ka qenë Tanasković Ljubiša¹, nuk ka qenë djalë i keq ai. Edhe menjherë mas luftës unë kom ardhë këtu me gjashtë shokë edhe e kemi çelë, e kemi zonë atë, e kom matë kom kqyrë a jonë krejt sendet, krejt, krejt, krejt i kishte pasë s’ka prekë asnjigjë.

Erëmirë Krasniqi: Aty në “Boro Ramiz”?

Shyqri Nimani: A?

Erëmirë Krasniqi: Aty në “Boro e Ramiz”?

Shyqri Nimani: Jo, këtu, këtu.

Erëmirë Krasniqi: Ata veç kishin ardhë këtu?

Shyqri Nimani: Po, se kqyre, se ata domethanë, kjo Galeria... mirë e ke ti, domethanë në ‘99—tën unë kom ardhë, na kemi ardhë këtu jo atje, por kur e kanë marrë ata? E kanë marrë... s’po më kujtohet qetashti kur me të vërtetë paska kalu. Mas luftës kemi ardhë këtu, po këtu ka qenë ai Tanasković para luftës. Domethanë paska kalu duhet me kqyrë a qetash bash mirë diskutojmë qysh paska kalu. Kështu që, mas luftës domethanë na kemi ardhë këtu në ‘99—shën, kemi hy brenda edhe e kemi pytë këtë Tanaskovićin, drejtorin, hinëm nalt aty edhe tha, i kqyrëm krejt “Ku është makina?” Thashë unë, tha,

¹ Ljubiša Tanasković (1942—2017) u lind në Sredskë afër Prizrenit, Kosovë. Piktore me profesion, Z. Tanasković ishte drejtori i Galerisë së Arteve të Prishtinës gjatë viteve 1990. Ai diplomoi nga École Nationale Supérieure des Beaux—Arts të Lionit, në Francë në vitin 1974, dhe magjistroi në Fakultetin e Arteve të Bukura në Prishtinë në vitin 1994.

“Makinën e kemi çu në Nish atje atje në servis”. Thashë, “Duhesh me pru makinën”. Atë makinë kurrë s’e kanë pru më. Ai ka ikë mandej.

Mirëpo, këtu të gjitha gjërat kanë qenë. E bëmë na një dokument, e kom shti në monografinë time unë, aty u vendosë na shtatë që jemi që unë ta udhëheqi Galerinë edhe për disa ditë deri sa ta shpallim konkursin për m’u zgjedhë drejtori edhe ashtu ka ndodhë mandej... Këtu ka qenë Liria [punonjëse e Galerisë], domethanë unë s’e kom marrë, vetëm formalisht e bëmë a din që ta ketë vazhdimësinë edhe mandej u shpall konkursi. Erdhi Luan Mulliqi, erdhi, ai më luti në shpi te une me rekomandu atë dhe e murë Luani. Edhe ai i ka pasë do sene të mira po edhe do sene shumë të këqija që thashë unë, është deshtë me e ndërto Galerinë, është deshtë me i kërku mjetet.